



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**


## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**


**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë-  
Kontabilitet”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S.Noli”,  
Korçë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Ingrid SHULI 

2. Prof.As. Artur RIBAJ 

Qershor/2021

## **TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë- Kontabilitet”**

|     |   |  |
|-----|---|--|
| Nr. |   |  |
| 1   | IAL aplikues:   | Universiteti “Fan. S. Noli”, Korçë                                   |
| 2   | Njësia bazë që e ofron:                                   | Departamenti i Financë- Kontabilitet                                 |
| 3   | Emërtimi i programit të studimit:                         | Bachelor në “Financë- Kontabilitet”                                  |
| 4   | Urdhëri/VKM i licencimit:                                 | Vendim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 142, datë 04.08.1998 |
| 5   | Urdhëri/VKM i riorganizimit:                              | -  |
| 6   | Forma e regjistrimit të diplomës:                         | UMASR Nr. 323, datë 05.06.2017                                       |
| 7   | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:                        | -  |
| 8   | Cikli i studimit:   | Cikli i parë   |
| 9   | Kohëzgjatja e programit të studimit:                      | 3 vite   |
| 10  | Kreditet në total (ECTS):                                 | 180 kredite  |
| 11  | Forma e studimit:   | Kohë e plotë   |
| 12  | Gjuha (shqip/tjetër):                                     | Shqip  |
| 13  | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | -  |
| 14  | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):                   | -  |
| 15  | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):                     | -  |
| 16  | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:            | Niveli 6   |
| 17  | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:          | 33 PAE/1 PAK   |
| 18  | Numri i studentëve (3 vitet e fundit):                    | (78+68+64)= 210  |
| 19  | Komente / të tjera:                                       |  |

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, (UNIKO), i krijuar me VKM Nr. 5 dt.07.01.1992, bazuar në veprimtarinë e Institutit të Lartë Bujqësor të Korçës (1971-1992). UNIKO ushtron veprimtarinë akademike shkencore bazuar në Ligjin Nr 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë. Programit i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë- Kontabilitet” të ofruar nga Departamenti i Financë- Kontabilitet pranë Universitetit “Fan S. Noli” Korçë është hapur bazuar në Vendimin Nr 142 datë 04.08.1998 (Shtojca 2.1).

GVJ vlerësoi RVB, dokumentacionin e dorëzuar në mbështetje të këtij vlerësimi dhe kreu takimet online me IAL me qëllim plotësimin e detyrimit ligjor të parashikuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. GVJ konstaton se RVB me pak sugjerime është përgatitur në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë për akreditimin e programeve të studimit të ciklit I.

Programi organizohet sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe për të fituar këtë diplomë duhen 180 kredite ( ECTS). Forma e studimit në programin e studimit Bachelor në “Financë- Kontabilitet” është me kohë të plotë dhe e organizuar në mënyrë të kujdesshme, për të harmonizuar të gjithë komponentët e tij, duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me organizimin e programeve të studimit (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018).

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm**

Realizimi i procesit të vlerësimit të jashtëm u mbështet në një seri dokumentesh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të njësive përkatëse që mbulojnë këtë program. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i cili ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyrore situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në Fakultetin e Ekonomisë, Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim ka dhe takimet online me Universitetin “Fan S. Noli” Korçë, (UNIKO), Fakultetit të Ekonomisë/ Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit në datat 08-09 Prill 2021, takimet me drejtues të këtij institucioni si dhe shqyrtimi i dokumentacionit bazë mbi të cilin organizohet i gjithë programi i studimit.

Gjatë takime online u realizuan takime me drejtues të Institucionit, me drejtues të Departamentit, Njësinë e Vlerësimit të Brendshëm, personelin akademik, studentë, sekretarinë mësimore, administratën, arkivin, bibliotekë etj. Gjithashtu, u bë vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni i cili aktualisht ishte drejt fazës finale të rikonstruksionit tërësor të tij. Kjo nuk na mundësoi të kishim një vështrim në laboratorët në dispozicion të këtij programi apo për infrastrukturën në klasa dhe zyrat e stafit akademik. Por, theksojmë se në të gjitha takimet dhe vizitat në mjediset e institucionit gjetëm bashkëpunim të plotë lidhur me punën tonë.

Gjykimi i grupit të vlerësimit të jashtëm u mbështet në evidentimet me zgjedhje të dokumentacionit në hallka të veçanta të UNIKO si Departament, NJSBC, Sekretarinë Mësimore, Bibliotekën, punonjës të administratës, etj. Gjithashtu, në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me procedurat e rekrutimit të stafit akademik efektivë apo me kontratë, cilësinë e studentëve, me të dhënat e studentëve në sekretari, me të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite, etj. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL.

**Shënim:** Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë pandemisë së COVID-19. Komunikimi me IAL është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132, datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91, dt. 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190, datë 19.03.2020.

Më datë 12/05/2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 2/27 Prot., datë 12/05/2021, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 20/05/2021 dhe me shkresë zyrtare Nr. 811/2 Prot., datë 24/05/2021.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi III.3 Kriteri 5,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** pasi vlerësimi i GVJ bazohet duke konsideruar të gjitha burimet e të dhënave dhe një i tillë ishte edhe takimi me stafin e UNIKO gjatë vizitës në IAL ku u konstatua gjetja e cituar në RVJ.

2. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.2 Kriteri 2,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon** pavarësisht depozitimit të një dokumenti shtesë pas kryerjes së vizitave në IAL, kjo është e pamjaftueshme për çfarë është evidentuar në RVJ ku kërkohet angazhim evident i DFK dhe stafit të tij përmes përfshirjes së tyre në projekte shkëmbimi ndërkombëtare në mësimdhënie, kërkim dhe bashkëpunim me universitete dhe partnerë të tjerë perëndimorë.

3. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.2 Kriteri 3,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon,** pasi GVJ në vlerësimin e tij bazohet në RVB si dokumenti kryesor i depozituar në ASCAL nga IAL përmes AMS. Referuar RVB-së, GVJ ka konstatuar se nuk ka evidenca që mund të tregojnë se çfarë ka bërë UNIKO për organizimin e programeve specifike për nxitjen dhe aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjive të reja nga personeli akademik e personeli mësimor-shkencor. Edhe komenti shtesë i dërguar mbetet i pa bazuar në evidence të shkruar në RVB.

4. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.2 Kriteri 4,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon,** pasi GVJ pavarësisht se konstaton se stafi akademik i përfshirë në mësimdhënie dëshmon një angazhim optimal, por kjo nuk është e mjaftueshme nga ana institucionale.

5. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.3 Kriteri 2,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon,** pasi GVJ gjatë vizitës në IAL konstatoi mungesë të infrastrukturës së nevojshme që garantonin realizimin cilësor të procesit mësimor. Kjo ka qenë evidentuar edhe nga vetë IAL dhe MASR përderisa këtyre ambjenteve ju ishin mundësuar fonde te buxhetit te shtetit per kryerjen e rikonstruksionit, i cili eshte ende në proces e sipër.

6. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi IV.3 Kriteri 4,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon,** pasi komentet nuk sjellin ndryshim të konstatimeve të GVJ-së, lidhur me mungesën e trajtimit të njohurive aplikative për lëndët e këtij programi

mësimor në laborator. Qëndrimi ynë është bazuar në pretendimet e ngritura nga vetë studentët, të cilët janë përfituesit kryesor të këtij programi studimi.

7. Për komentin e IAL mbi konstatimin e GVJ në **Standardi V.6 Kriteri 2,**

**GVJ konkludon që Raporti në këtë pikë nuk ndryshon,** pasi GVJ ka marrë për vlerësim vitet e shkuara akademike për këtë program studimi bazuar në RVB si edhe në intervistat e kryera në IAL dhe ato çfarë të intervistuarit kanë evidentuar. Gjithashtu, gjatë intervistave në vizitat e kryera në IAL, GVJ vlerësoi faktin që për këtë vit akademik UNIKO kish përcaktuar MS Teams si platformë për zhvillimin e komunikimit dhe mësimin me studentët e tij dhe si përfundim GVJ e ka vlerësuar të plotësuar këtë standard.

# Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë - Kontabilitet”

## I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

| <b>Standardi I.1</b>  |   |
|---|---|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b> |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.   | <p>Sipas takimeve online në institucion, dokumentacionit<sup>1</sup> që është përcjellë nga IAL, DVV, rezulton se Universiteti i Korcës UNIKO është akredituar institucionalisht me Vendim<sup>2</sup> të Bordit të Akreditimit Nr. 65, datë 21.09.2017, ndërsa programi i studimit Bachelor në “Financë- Kontabilitet” është hapur bazuar në Vendimin<sup>3</sup> Nr 142 datë 04.08.1998.</p> <p>Misioni i UNIKO-së për programin e studimit Bachelor në “Financë- Kontabilitet” është ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës për studentët që përzgjedhin këtë program, ofrimi i kualifikimit dhe i ndjekjes së veprimtarive të tjera të lidhura me punësimin.</p> <p>Vizioni i UNIKO-së është promovimi i vlerave kombëtare përmes ofrimit të edukimit/arsimit me qëllim nxitjen e respektimit të etikës qytetare, të profesionalizmit, nxitjen e respektimit të kodeve të sjelljes, me synim formimin e një qytetarie model për konsolidimin e vlerave dhe interesave kombëtare në fushën e arsimit.</p> <p>UNIKO ofron programe studimi në përputhje me politikat kombëtare, duke përgatitur specialistë të aftë për sipërmarrje, inovacion, duke mundësuar dhe punësimin në përgjigje të interesave kombëtare.</p> |
| <b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.  | <p>Mbështetja dhe promovimi i vlerave kombëtare është detyrim i UNIKO-së. Personeli akademik i Fakultetit të Ekonomisë ka punuar për zhvillimin e programeve të shkencave ekonomike në UNIKO. Lidhur me këtë një ndihmesë e madhe ka qenë bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit me të cilat UNIKO-ja ka marrëveshje<sup>4</sup>.</p> <p>Programet e studimit të UNIKO, por në veçanti ky program i studimit Bachelor<sup>5</sup> në Financë – Kontabilitet, synon transmetimin e njohurive</p>   |

<sup>1</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e UNIKO.pdf,

Evidenca 2.13 Organika e FE.pdf,

Evidenca 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit

<sup>2</sup> Evidenca 2.19, Vendimi për akreditimin institucional të UNIKO, Vendim 65, datë 21.09.2017, Bordi i Akreditimit.pdf


<sup>3</sup> Evidenca 2.1 Dokument i licensimit të Programit të Studimit

<sup>4</sup> Evidenca 2.10 UNIKO Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.pdf;

Evidenca 3.17 Tabela përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale.pdf;

Evidenca 2.14 Marrëveshje institucionale.pdf

<sup>5</sup> Evidenca 2.5 Rregullorja e Programit të Studimit



|  |   |                                     |                                    |                                     |
|--|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
|  | <p>në shërbim të vendit dhe shoqërisë. Këto programe synojnë kualifikimin profesional të studentëve në fushën e ekonomisë, e vecanërisht në profilet specifike Financë e Kontabilitet. Kërkimi shkencor është pjesë integrale e këtij program studimi, duke i nxitur studentët jo vetëm të kualifikohen në fushën përkatëse, por edhe të bashkëpunojnë me pedagogët në kërkimin shkencor, si dhe të punojnë për kërkim të pavarur në këto fusha.</p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> | <p>Nisur nga RVB<sup>6</sup>-ja dhe dokumentacioni<sup>7</sup> që është përcjellë nga IAL, DVV, Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është në përputhje me synimet dhe misionin e institucionit sipas statutit dhe strategjisë së UNIKO. Misioni i institucionit konsiston në edukimin e studentëve në fushat e ekonomisë duke u mbështetur në programe bashkëkohore studimi, në kërkimin shkencor, në vënien në praktikë të dijeve të marra nga studentët në bizneset private, pranë institucioneve publike, organizatave jo fitimprurese, etj.</p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>           | <p>Gjatë takimeve online në institucion dhe dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, GVJ konstatoi që ky program studimi që kërkohet të akreditohet është hartuar nga UNIKO-ja në përputhje me kërkesat e zhvillimit ekonomik të vendit, duke ofruar module të kombinuara me karakter të mirëfilltë teorik e praktik, nga fusha ekonomiko-shoqërore, njohuri për sipërmarrjen, duke përfshirë praktikat profesionale etj. Në planet mësimore<sup>8</sup>, programet e lëndëve<sup>9</sup> (syllabuset), pasqyrohen kërkesat e VKM Nr 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, i ndryshuar me VKM Nr. 897 date 18.12.2019, si dhe Udhëzimi Nr 1, date 14.01.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njesive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve”. Ofrimi i këtij program studimi ka ardhur si kërkesë e tregut për specialistë të financës, kontabilitetit dhe të bankës. Studimet në këtë program synojnë të pajisin studentët me njohuri teorike e praktike, si dhe përgatitje për kërkim shkencor të pavarur në këto fusha.</p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>  | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|  |   |                                     |                                    | X                                   |

**Standardi I.2**

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

|                 |                               |
|-----------------|-------------------------------|
| <b>Kriteret</b> | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b> |
|-----------------|-------------------------------|

<sup>6</sup> Dokumenti 25 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Financë Kontabilitet 2020.pdf

<sup>7</sup> Evidenca 1.1 Statuti i UNIKO.pdf

Evidenca 1.3 Plani strategjik UNIKO 2016-2020.pdf

<sup>8</sup> Evidenca 2.7 Plani mësi mor i Programit të studimit

<sup>9</sup> Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit.pdf



|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.   | Referuar dokumentit “Plani Strategjik <sup>10</sup> UNIKO 2016-2020” miratuar me vendim Senati, referuar RVB <sup>11</sup> -së dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton që hartimi dhe përditësimi i Programit të Studimit mbështetet gjatë realizimit të tij në strategjinë për zhvillimin e institucionit, dokument ky i diskutuar në departamente për të marrë edhe mendimet e personelit akademik dhe i miratuar në strukturat drejtuese të UNIKO.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Referuar statutit <sup>12</sup> të UNIKO dhe Rregullores <sup>13</sup> së programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, ky program studimi ofron përgatitje dhe diplomim të studentëve me një spektër të gjere njohurish në fushën e financës, kontabilitetit, pa lënë pa përmendur lëndë si matematika, informatika, manaxhimi i biznesit, sipërmarrja. Në këtë mënyrë studentët marrin njohuri të domosdoshme për zhvillimin e karrierës dhe u krijohen mundësi për të mësuar e për t’u kualifikuar për zhvillimin në profesion gjatë gjithë jetës.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.   | Emërtimi i programit të studimit i referohet dhe është i lidhur drejtpërdrejt me fushat që ka vendosur ndër prioritetet e tij UNIKO, bazuar në Statut <sup>14</sup> dhe në përputhje me kuadrin ligjor <sup>15</sup> në fuqi, konkretisht në VKM nr 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, i ndryshuar me VKM nr. 897, datë 18.12.2019, si dhe Udhëzimi Nr 1, datë 14.01.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njesive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-eve”. Programi i studimit përbëhet nga elementet mësimore si lëndet, modulet, praktika mësimore, diploma, të cilat formojnë studentet si nga pikëpamja teorike ashtu edhe nga ajo praktike në fushën e financës e kontabilitetit. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

|  |   |
|--|---|
| <b>Standardi I.3</b>   |   |
| <b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>   |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat | Objektivat kryesore të këtij program studimi në “Financë-Kontabilitet”, janë rezultat i pritshëm i arritjeve të studentëve në procesin mësimor e edukativ në përputhje me kërkesat rregullatore <sup>16</sup> . Ky program studimi Bachelor në “Finance Kontabilitet”, synon të përgatisë specialistë të mirë në fushat e studimit që mbulon, për t’i |

<sup>10</sup> Evidenca 1.3 Plani strategjik UNIKO 2016-2020.pdf

<sup>11</sup> Dokumenti 25 Raporti i Vleresimit të Brendshëm Finance Kontabilitet 2020.pdf

<sup>12</sup> Evidenca 1.1 Statuti i UK, pdf

<sup>13</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e UK.pdf

<sup>14</sup> Evidenca 1.1 Statuti i UK, pdf

<sup>15</sup> Evidenca 2.5 Rregullore e programit të studimit.pdf

Evidenca 2.26 Kuadri i përgjithshëm formues i programit Bachelor Financë Kontabilitet, pdf.

<sup>16</sup> Evidenca 2.5 Rregullore e programit të studimit.pdf

Evidenca 2.26 Kuadri i përgjithshëm formues i programit Bachelor Financë Kontabilitet, pdf.

|  |   |
|--|---|
| <p>profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>  | <p>përgatitur për tregun e punës, si kontabilistë, financierë, punonjës të bankave, në fushën e administrim biznesit, në institucionet financiare etj., nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Transmetimit të njohurive ekonomike e aftësive praktike;</li> <li>• Zhvillimit të aftësive individuale të studentëve për të bërë analiza në fushat e kërkimit;</li> <li>• Aftësim për të analizuar e zgjidhur probleme individualisht apo në grup të studentëve.</li> </ul>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p> | <p>Sipas dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, RVB<sup>17</sup>, programi i studimit bachelor në “Financë Kontabilitet”, zhvillohet bazuar në prirjet, prioritetet e zhvillimit të ekonomisë në nivel kombëtar, duke iu referuar publikimeve të organizmave dhe Institucioneve kryesore ekonomiko-financiare në vend si psh: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, publikime të institucioneve ndërkombetare, si Banka Botërore, FMN etj.</p> <p>Për hapjen e këtij programi, sipas informacionit të marrë nga vizita në institucion nuk është kryer studim i tregut, për të argumentuar rëndësinë dhe domosdoshmërinë e këtij program studimi. Institucioni është nisur nga kërkesat e studentëve, mendimet e sugjerimet e studentëve që kanë përfunduar studimet në UNIKO, në eksperiencën e Fakultetit Ekonomik të UT.</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>   | <p>Fushat e studimit të përfshira në këtë program studimi, krijojnë mundësinë që pas marrjes së diplomës Bachelor në Financë Kontabilitet, studentët të kenë mundësi punësimi në zyra kontabiliteti, biznese, banka, institucione financiare, etj. Për identifikimin e vlerësimin e nevojave të tregut të punës UNIKO i është drejtuar Qendrës së Karrierës dhe Alumnit (QKA)<sup>18</sup>, e cila ka përgatitur data bazë të studentëve të diplomuar në vite, për të ndjekur edhe preferencat e tyre dhe të tregut të punës për financierë e kontabilistë, por edhe për të orientuar studentët.</p> <p>Struktura e programit të studimit, objektivat formues dhe përmbajtja e programeve të këtij programi studimi, u garantojnë studentëve marrjen e njohurive, dijeve, aftësive e kompetencave për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut dhe për të lehtësuar e mundësuar punësimin<sup>19</sup> e studentëve.</p> <p>Një shembull i mirë janë leksionet e hapura me specialistë të fushave të ndryshme për të sjellë ekspertizën e tyre në auditor, si edhe mbikqyrja e studentit në praktikën mësimore si pjesë e programit mësimor, nga specialistë të bizneseve ku kryhet praktika mësimore.</p> <p>UNIKO ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me njesi biznesi, me institucione tëpushtetit lokal, me institucione bankare, financiare për të cuar studentë për praktika mësimore, për të marrë kërkesat specifike të tyre mbi aftësitë dhe kompetencat që duhet të kenë fituar</p> |

<sup>17</sup> Dokumenti 25 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf

<sup>18</sup> Evidenca 1.5 Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave NJSBC, QKA.pdf;

<sup>19</sup> Evidenca 4.6 Tabela përmbledhëse për punësimin e studentëve të programit të studimit.pdf

|                                     |   |                       |                      |                       |
|-------------------------------------|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|                                     | studentët në këtë program studimi. UNIKO ka shkëmbime ndërkombëtare me disa institucione e universitete, që i shërbejnë këtij qëllimi të rëndësishëm, shkëmbimit të eksperiencave. UNIKO lehtëson punësimin e studentëve, por edhe i ndjek ata në karrierën e tyre përmes Qendrës së Karrierës dhe Alumnit (QKA). |                       |                      |                       |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet  | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|                                     |   |                       |                      | X                     |

| <b>Standardi I.4</b>  |  |
|---|--|
| <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>   |  |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.  | Sipas RVB <sup>20</sup> e vizitës në institucion, dhe sipas evidencave të përcjella nga IAL, DVV, rezultoi se Fakulteti i Ekonomisë në UNIKO, nxit inovacionin në mësimdhënie në një mjedis ku në qendër është studenti, duke shfrytëzuar teknologjitë e reja në mësimdhënie, duke promovuar e rritur rolin e tij në procesin e zhvillimit të shoqërisë, si dhe përmes transferimit të teknologjisë dhe informacionit. Të gjitha programet e studimit përfshirë dhe ai i Financës, që ofron Fakulteti i Ekonomisë në UNIKO, janë në përputhje me fushën e studimit që mbulon Fakulteti i Ekonomisë dhe njësia bazë që zbaton këtë program studimi. Fakulteti i Ekonomisë disponon kapacitetet akademike dhe të infrastrukturës, për zbatimin e këtij program studimi, në përputhje me standartet e cilësisë. Personeli akademik <sup>21</sup> (efektiv apo me kontratë) i Fakultetit të Ekonomisë të UNIKO, respekton kriteret ligjore të titujve dhe gradave, për çdo njësi bazë dhe për çdo cikël studimi. Konkretisht janë angazhuar në këtë program studimi 5 personel akademik me titull Prof. As, 7 personel akademik me gradë Doktor dhe 2 personel akademik asistent lektor. |
| <b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | GVJ, referuar RVB-se si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, vlerëson se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet" është në përputhje <sup>22</sup> me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë, sipas klasifikimit të programeve të studimit, në përputhje me udhëzimet kombëtare e evropiane. Përmendim se referuar fushave të përgjithshme studentët marrin njohuri e aftësohen për tregun e punës, duke njohur funksionimin e institucioneve financiare, bankare, shoqërive aksionare, duke studiuar kontabilitetin, e duke marrë formim profesional në fushën përkatëse. Ndërsa, referuar fushës specifike, kurrikula e studimeve mundëson që studentët të përgatiten si specialistë të aftë të fushës së financës, kontabilitetit, bankave dhe institucioneve financiare.   |

<sup>20</sup> Dokumenti 25 Raporti i Vleresimit te Brendshem.pdf,

<sup>21</sup> Evidenca 4.1 Tabela e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit.pdf;

<sup>22</sup> Evidenca 2.5 Rregullore e programit të studimit.pdf

Evidenca 2.26 Kuadri i përgjithshëm formues i programit Bachelor Financë Kontabilitet, pdf.

|  |   |                                     |                                    |                                     |
|--|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p> | <p>Referuar RVB<sup>23</sup>-se, Rregullores<sup>24</sup> së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë Kontabilitet dhe takimeve me drejtues të njesisë kryesore dhe të njesisë bazë, rezulton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë bazë, pra të Departamentit Financë Bankë, përgjegjës për programin e studimit, duke respektuar klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Departamentit Financë Kontabilitet si njesi bazë përgjegjëse për këtë program studimi, angazhohet për të mbuluar të gjitha lëndët e planit mësimor. Për programet me karakter ndërdisiplinor, apo kur bëhet fjalë për lëndë specifike, apo për lënde të trungut, të dy viteve të para, në të cilat studentët zhvillojnë të njëjtat lëndë, në bazë të marrëveshjeve, bashkëpunon me IAL të tjera, jashtë UNIKO, apo angazhon personel akademik të njesive të tjera bazë.</p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>  | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
| <p>X</p>   |   |                                     |                                    |                                     |

**Standardi I.5**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

| Kriteret   | Vlerësimi i ekspertëve  |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> | <p>Në takimet me drejtuesit e njesisë kryesore, bazuar edhe në Organikën e UK, GVJ-ja konstatoi se në UK të gjitha strukturat administrative<sup>25</sup> dhe akademike të institucionit bashkëpunojnë me njera-tjetrën për realizimin e synimeve të këtij programi studimi, lidhur me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe aktivitetet e tjera ekstra kurrikulare. Të gjitha detyrat specifike të personelit akademik, të njesive bazë e të njesive kryesore në këtë kuadër janë përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore, në statutin<sup>26</sup> e UK, në rregulloren<sup>27</sup> e UNIKO dhe në rregulloren<sup>28</sup> e njesisë kryesore, pra Fakultetit të Ekonomisë. Me qëllim marrjen e informacionit për ecurinë, çdo hallkë e këtij institucioni, UK, raporton në mënyrë periodike për aktivitetet e kryera. Çdo njesi bazë bën analizë<sup>29</sup> periodike të punës së stafit të vet akademik, përmes matjes së performancës së mësimdhënies dhe rezultateve semestrale dhe vjetore të studentëve, të cilat më pas bëhen</p> |

<sup>23</sup> Dokumenti 25 Raporti i Vleresimit te Brendshem. pdf

<sup>24</sup> Evidenca 2.5 Rregullore e programit të studimit.pdf

Evidenca 2.26 Kuadri i përgjithshëm formues i programit Bachelor Financë Kontabilitet, pdf.

<sup>25</sup> Evidenca 2.13 Organika e FE UK .pdf;

<sup>26</sup> Evidenca 1.1 Statuti i UK.pdf;

<sup>27</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e UK, pdf.

<sup>28</sup> Evidenca 2.2 Rregullore e njesisë kryesore.pdf;

<sup>29</sup> Evidenca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njesisë bazë.pdf

|  |   |
|--|---|
|  | pjesë e Raportit të aktivitetit mëimor, kërkimor dhe financiar të Fakultetit të Ekonomisë të UK.  |
| <b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj. | GVJ, referuar RVB <sup>30</sup> -se si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstaton se UNIKO ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione të arsimit të lartë brenda vendit, po kështu në nivel akademik bashkëpunon edhe me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit. UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione private e publike të vendit apo ndërkombëtare. Marrëveshje ka edhe mes UNIKO-se e aktorëve të biznesit vendas e të huaj. Sipas shtojcës 2.2, UNIKO ka 28 marrëveshje <sup>31</sup> bashkëpunimi institucionale (Shtojca 3.17), si u përmendën më lart në këtë kriter.   |
| <b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.                            | Njesia përgjegjëse e këtij program studimi është Departamenti Financë Kontabilitet, në Fakultetin e Ekonomisë. Kjo njesi bazë si edhe njesitë e tjera bazë të këtij fakulteti, analizojnë peridikisht përfitimet e programit të studimit nga marrëveshjet e nënshkruara <sup>32</sup> si në kriterin më sipër. Rezultatet e këtyre analizave bëhen pjesë e Raportit vjetor të aktivitetit mësimor, kërkimor e financiar të FE. Studentët e FE-se dhe personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në akreditim, kanë përfituar nga marrëveshjet me biznesin për praktika mësimore e deri në punësim. Specifikat e realizimit të praktikave mësimore paraqiten në rregulloren e posacme të praktikave,   |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.                                      | Sipas RVB <sup>33</sup> , vizitës në institucion e dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, si edhe në kriteret 2.3, GVJ konstaton se UNIKO-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me biznese, për kryerjen e praktikave mësimore. Në bazë të marrëveshjes që UNIKO ka bërë, sipas shtojcave 2.10 e 2.14, nga institucioni apo biznesi pritës i studentëve, vendoset një mbikqyrës praktike, i cili i monitoron gjatë gjithë periudhës së parashikuar në planin mësimor për praktikën dhe më pas bën edhe vlerësimin e punës së studentit, vlerësim ky që i bashkëngjitet vlerësimit të pedagogut udhëheqës, deri në mbrojtjen para komisionit të praktikës mësimore. Sigurohet vend praktike në varësi të natyrës specifike të programit të studimit, kështu studentët e këtij program studimi Financë Kontabilitet, zhvillojnë praktikën në zyra kontabiliteti, në banka, në shoqëri sigurimesh, apo në institucione të tjera financiare, në shoqëri tregtare etj. UNIKO-ja rezulton se ka kontakte të vazhdueshme me bizneset me të cilat ka marrëveshje jo vetëm për praktikat e studentëve, por edhe për trajnime profesionale të stafit të këtyre bizneseve apo për shkëmbim eksperiencë në auditorë nga drejtuesit e këtyre bizneseve. Nga Evidencat 2.10 e 2.14, 3.17, rezultojnë mjaft marrëveshje të |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.   |   |

<sup>30</sup> Dokumenti 25 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf,

<sup>31</sup> Evidenca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale, pdf;

Evidenca 2.14 Marrëveshje institucionale.pdf; Evidenca 3.17 Tabela përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale.pdf

<sup>32</sup> Evidenca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.pdf;

Evidenca 2.14 Marrëveshje institucionale.pdf;

Evidenca 3.21 Udhëzues i praktikave mësimore pdf.

Shtojcë 3.6 Raport i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të studimit.pdf

<sup>33</sup> Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf; Shtojcë 3.6 Raport i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të studimit.pdf; Evidenca 2.5 Rregullore e programit të studimit.pdf;

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | nënshkuara mes UNIKO dhe disa universiteteve të huaja dhe bizneseve, ku studentët mund të kryejnë praktikat mësimore. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              |                             | X                            |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| <b>Standardi II.1</b>  |  |
|--|--|
| <b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>  |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit Bachelor në “Financë - Kontabilitet” është i hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, përmendim VKM nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Struktura e këtij programi studimi pasqyrohet në Rregulloren e Programit <sup>34</sup> të studimit, ku lëndët janë të ndara në elemente mësimore që përcaktohen në VKM nr 41, datë 21.04.2018, duke respektuar të gjitha limitet e shprehura në orë e në kredite ETCS. Programi i studimit organizohet sipas planit të zhvillimit institucional dhe strategjisë së zhvillimit ekonomik kombëtar, në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ETCS).                  |
| <b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.  | Nisur nga RVB <sup>35</sup> e vizita në institucion, informacioni i marrë nga takimet <sup>36</sup> me drejtues të UNIKO, nga Shtojca 2.26 Kuadri i përgjithshëm <sup>37</sup> formues i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë Kontabilitet”, GVJ vëren se ky Program studimi synon përgatitjen e formimit të disa lloje specialitetesh e profesionesh si: financier, kontabilist, këshilltar investimesh, këshilltar financiar, analist financiar. Struktura e programit të studimit, nëpërmjet kombinimit të lëndëve karakterizuese të programit studimit, me lëndët karakterizuese të profilit specifik Financë e Kontabilitet; mendohet se do plotësojë kërkesat e tregut për specialistë të këtyre profileve. |
| <b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.  | Programi i studimit <sup>38</sup> Bachelor në “Financë Kontabilitet” është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe me objektivat strategjike të UNIKO. Referuar strukturës së programit studentët përfitojnë njohuri të përparuar në nivel programi si: Matematikë, Mikroekonomi, Makroekonomi, Manaxhim i Operacioneve, etj., dhe gjithashtu njohuri të përparuar në nivel profili specifik si: Tregje Financiare, Analiza e Pasqyrave Financiare, Drejtim Financiar, Kontabilitet Publik, Financa Publike, etj.   |
| <b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të  | Kurrikula e programit të studimit në Financë Kontabilitet, sikurse është përmendur në kriterin 3 më lart, përmban lëndë sidomos në vitin e tretë të studimit (si lëndët e përmendura në kriterin 3 më lart), që zhvillohen   |

<sup>34</sup> Evidenca 2.5 Rregullore e programit të studimit.pdf

Evidenca 2.7 Plani Mësimor i programit të studimit.pdf

<sup>35</sup> Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf

<sup>36</sup> Evidenca “Minutat e takimit me drejtues të FE”

<sup>37</sup> Evidenca 2.5 Rregullore e programit të studimit.pdf

Evidenca 2.7 Plani Mësimor i programit të studimit.pdf;

<sup>38</sup> Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit.pdf; Evidenca 1.2 Plani strategjik UNIKO 2016-2020.pdf

|  |  |                                     |                                    |   |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p>avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>           | <p>edhe në programet master, duke synuar të ofrohen njohuri të avancuara në nivel akademik, por edhe aftësi praktike dhe kompetenca të avancuara, të realizuara përmes detyrave apo projekteve specifike në secilën lëndë. Po kështu, sipas informacioneve të marra në UNIKO, studentët që përfundojnë studimet bachelor, mund të vazhdojnë studimet në master në një fushë të studimeve që ofron UNIKO.</p>   |                                     |                                    |   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>        | <p>Ashtu si është përmendur në kriterin 1 të këtij Standarti, struktura e Programit të studimit në “Financë Kontabilitet”, është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore në fuqi dhe me VKM nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në veçanti. Studenti në përfundim të ciklit të parë të studimeve siguron, pas 3 vite studimi, 180 kredite ETCS. Sipas VKM 41, 15-20% të krediteve të programit mësimor duhet ta përbëjnë lëndët bazë (kategoria A e veprimtarive formuese), të përgatisin studentin nga pikpamja metodologjike dhe me kulturë të përgjithëshme, 50-55% të krediteve të duhet të jenë lëndë karakterizuese ose lëndë që e përgatisin studentin për disiplinën shkencore (kategoria B); 12-15% të krediteve të programit të studimit e zënë lëndë ndërdisiplinore/integruese, ku përfshihen nëndisiplina, profile dhe gruplëndë me zgjedhje (kategoria C), 10-15% të krediteve duhet të jenë lëndë plotësuese si gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (kategoria D) dhe 3-5% të krediteve programit e zënë detyrimet përmbyllëse (kategoria E). Duke krahasuar kriteret e VKM me përfshirjen në planin mësimor të programit mësimor<sup>39</sup> situata paraqitet:</p> <p>Për profilin Kontabilitet për të tre vitet:</p> <p>Lëndë të kategorisë A zenë 34 kredite ose 18,9%, pra brenda kriterit të VKM 41.</p> <p>Lëndë të kategorisë B 91 zenë kredite ose 50,5%, pra brenda kriterit të VKM nr 41.</p> <p>Lëndë të kategorisë C zenë 26 kredite, ose 14,5%, brenda kriterit.</p> <p>Lëndë të kategorisë D zenë 23 kredite ose 12,8%, Brenda kriterit.</p> <p>Lëndë të kategorisë E zenë 6 kredite ose 3.3%, brenda kriterit.</p> |                                     |                                    |   |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p> | <p>Sipas shpjegimeve të dhëna në kriterin 6 më sipër, sipas RVB<sup>40</sup>-së rezulton se në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet”, janë të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive nga A-E dhe me ngarkesën përkatëse në kredite, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara nga MASR-ja. Më konkretisht për këtë çështje i jemi referuar për përputhshmëri, VKM nr.41, datë 21.04.2018, “Për elementet e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.</p>   |                                     |                                    |   |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>   | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |

<sup>39</sup> Evidenca 2.7 Plani Mësimor i programit të studimit.pdf;

<sup>40</sup> Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf



| <b>Standardi II.2</b>   |  |
|---|--|
| <b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>  |  |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.   | GVJ-ja, referuar RVB-se si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstaton se UNIKO-ja është një institucion i akredituar me Vendim <sup>41</sup> të Bordit Akreditimit, Nr 65 datë 21.09.2017, pas riorganizimit të UNIKO-së në universitet. Fakulteti i Ekonomisë në UNIKO përbëhet nga <sup>42</sup> 3 njësi bazë, stafi i të cilave plotëson kriteret ligjore për funksionimin e këtyre njesive bazë. Departamenti Financë Kontabilitet në vitin 2019-2020 raporton se ka në përbërje 14 personel akademik efektiv (PAE), 19 personel akademik që nuk janë pjesë e DFK por departamenteve të tjera të UNIKO. Këta të fundit janë pedagogë të departamenteve të tjera brenda FE apo brenda UNIKO që japin lëndë në këtë program studimi, sipas planit mësimor. Pra, janë gjithsej 33 personel akademik <sup>43</sup> PAE që zhvillojnë mësim në këtë program studimi. Nga këta 11 janë Prof. As., 15 anëtarë të personelit akademik janë me grad Doktor dhe 7 janë Msc dhe 1 personel me kontrat PAK Msc, duke plotësuar kriteret ligjore, ndërsa stafi ndihmës akademik dhe ai administrativ është i organizuar në nivel institucioni, pra si UNIKO. Programi i studimit Bachelor “Financë Kontabilitet” ofrohet nga Departamenti i Financë Kontabilitet. |
| <b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse. | GVJ-ja, konstaton sipas Shtojcës 2.11 Vendimi i njesisë bazë për emërimin e koordinatorëve të programit të studimit, se për ecurinë e programit të studimit, për ndjekjen e praktikave mësimore të studentëve janë përcaktuar nga cdo njësi bazë koordinatorët e programeve të studimit për cdo njësi bazë. Kështu, sipas dokumentit të mësipërm, nga Departamenti Financë Kontabilitet, janë përcaktuar 2 koordinatorë, personel akademik efektiv i kësaj njesie bazë, njeri prej tyre për programin e studimit bachelor. Koordinatorët e programit të studimit dhe të praktikave profesionale informojnë njësinë bazë për ecurinë, dhe nëse ka problematika ato bëhen objekt i analizave e diskutimeve në njësinë bazë. Sipas udhëzuesit 3.21 të praktikës mësimore, përcaktohen palët pjesëmarrëse në realizimin e praktikës, përgjegjësitë e Departamentit të Financë Kontabilitetit, të studentit e të palës pritëse ku studenti do të zhvillojë praktikën mësimore. Njësia bazë ka nënshkruar marrëveshje <sup>44</sup> me biznese, institucione qendrore e lokale për kryerjen e praktikave mësimore. Përgjegjës <sup>45</sup> për ndjekjen e studentëve në praktikë janë edhe pedagogët udhëheqës.   |
| <b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet   | Për të realizuar këtë program studimi të ciklit të parë Bachelor në Financë Kontabilitet, sipas Shtojcës 2.13, Organika e FE, në UNIKO janë ngritur strukturat përkatëse në zbatim të legjislationit në fuqi e për të plotësuar  |

<sup>41</sup> Evidenca 2.19 Vendim i BA nr 65, datë 21.09.2017 për Akreditim Institucional.pdf;

<sup>42</sup> Evidenca 2.13 Organika e FE.pdf;

<sup>43</sup> Evidenca 4.1 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit.pdf

<sup>44</sup> Evidenca 3.21 Udhëzues i praktikës mësimore.pdf; Evidenca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.pdf;

<sup>45</sup> Evidenca 2.11 Vendim i njesisë bazë për emërimin e koordinatorëve të programit të studimit.pdf;

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.   | objektivat e misionin e këtij program studimi. UNIKO si njesi kryesore është e përbërë nga tre njesi bazë: Departamenti FinancëKontabilitet, Departamenti Manaxhimit, Departamenti Marketing Turizëm. Secila prej njesive bazë ka në përbërje të saj jo më pak se 7 pedagogë efektivë, nga të cilët minimalisht 3 prej tyre mbajnë gradë e tituj. Konkretisht Departamenti i Kontabilitetit me 14 personel akademik efektivë, Departamenti i Manaxhimit me 10 personel akademik efektiv dhe Departamenti i Marketing Turizëm me 10 personel akademik efektiv.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.   | Sipas RVB-së, Shtojcës 2.13 Organika <sup>46</sup> FE, rezulton se Fakulteti Ekonomisë në UNIKO, ka në përbërje 34 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 14 personel akademik me titull Prof.As., 10 personel akademik me gradë Doktor, 10 personel akademik Master i Shkencave (Msc).  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Ndërsa, njesia bazë, Departamenti Financë Kontabilitet në Fakultetin e Ekonomisë të UNIKO, ka në përbërje 14 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 5 personel akademik mbajnë titullin Prof.As., 5 prej stafit akademik mbajnë gradën shkencore Doktor, 4 janë personel akademik Master i Shkencave (Msc). Gjithashtu, kjo njesi bazë ka në përbërje edhe 19 personel akademik të ftuar nga departamente të tjera të UNIKO. Këta të fundit janë pedagogë të departamenteve të tjera brenda FE apo brenda UNIKO që japin lëndë në këtë program studimi, sipas planit mësimor. Nga këta 19 personel akademik, 7 prej tyre mbajnë titullin Prof. As., 10 mbajnë gradën Doktor, 2 personel akademik janë me diplomën Master Shkencor (Msc). |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve  |
|---|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Sipas organikës së Fakultetit të Ekonomisë, të UNIKO, e si është shpjeguar në RVB, Departamenti i Financë Kontabilitet si njesi bazë përgjegjëse për programin e studimit, është njesia që propozon dhe ndjek mbarëvajtjen e programit të studimit dhe ndryshimet përkatëse. Çdo propozim për programet e studimit niset nga njesia bazë dhe kalon të gjitha hallkat drejt miratimit të tij nga Senati akademik. Në këtë këndvështrim, të gjitha këto hallka, Departamenti Financë Kontabilitet, Fakulteti Ekonomisë, e kanë të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit që zhvillohen në UNIKO. |

<sup>46</sup> Evidenca 2.13 Organika e FE.pdf; Evidenca 2.26 Kuadri i përgjithshëm formues i programit bachelor në Financë Kontabilitet.pdf; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm.pdf, Evidenca 4.1 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit. pdf

|  |  |
|--|--|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>             | <p>Programi i studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet”, sipas<sup>47</sup> Rregullores së programit, organizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë të veçantë sipas VKM nr 41, datë 21.04.2018, “Për elementet e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Sipas VKM së mësipërme elementët që përbëjnë strukturën e programeve të studimit janë: kreditet (ETCS), kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, objektivet formues e kompetencat profesionale, veprimtaritë formuese e komponentët mësimorë të programit të studimit, kategoritë e veprimtarive formuese, plani mësimor, programet e lëndëve, etj.</p> <p>Para fillimit të vitit akademik njesia bazë përgjegjëse për programin e studimit përgatit e diskuton Planin mësimor dhe ia propozon Senatit Akademik për miratim.</p> <p>Në planin mësimor ndarja e lëndëve/moduleve, bëhet në disa kategori nga A-E: lëndë të formimit të përgjithshëm (A), lëndë të formimit karakterizues (B), lëndë me zgjedhje (C), lëndë të formimit plotësues, si praktika (D) dhe tema e diplomës (E). Për ndarjen e lëndëve në kategoritë e mësipërme i jemi referuar edhe suplementit të diplomës.</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p> | <p>Njesia bazë përgjegjëse për këtë program studimi mban parasysh e zbaton sistemin europian për organizimin e programit të studimit në lëndë e module. <sup>48</sup>Plani mësimor si element përbërës i programit të studimit është i përbërë nga lëndë apo module. Në planin mësimor, çdo lëndë apo modul është i shprehur në kredite (ETCS), në orë mësimore, të ndara në leksione, seminare, praktikë, provime, në orë punë individuale të studentit. Në VKM nr 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, paraqitet në shtojcën 1, veprimtaritë formuese të ndara në kategori si më poshtë:</p> <p>A-Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithëshme (15-20%= 34 kredite).</p> <p>B-Lëndë karakterizuese: përgatitje për disiplinën shkencore: (50-55% = 91 kredite).</p> <p>C-Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese: Lëndë të formimit të ngjashëm ose / dhe integruese si dhe lëndë formuese të zgjedhura nga studentët: (12-15% = 26 kredite).</p> <p>D-Lëndë plotësuese: Lëndë formuese dhe aktivitete që lidhen me përfundimin e aftësive për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës si: për njohje të gjuhës së huaj, informatikës, praktikë mesimore: (10-15% = 23 kredite).</p> <p>E-Detyrime përmbyllëse: Teza e diplomes: (3-5% = 6 kredite).</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën</p>  | <p>Si është përmendur në kriteret 2, 3 të këtij standarti, në dosjen e programit të studimit ndodhet Rregullorja e programit, e cila është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Plani mësimor si një ndër elementet e programit të studimit përmbledh Lëndet/modulet të</p>   |

<sup>47</sup> Evidenca 2.5 Rregullore e programit të studimit.pdf; Evidenca 2.7 Plani Mesimor i programit të studimit.pdf; Evidenca 2.6 Modeli i diplomës-suplementit të programit të studimit.pdf

<sup>48</sup> Evidenca 2.3 Kurrikula e programit.pdf; Evidenca 2.5 Rregullore e programit të studimit.pdf; Evidenca 2.7 Plani Mesimor i programit të studimit.pdf; Evidenca 2.6 Modeli i diplomës-suplementit të programit të studimit.pdf

|  |  |
|--|--|
| <p>mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>   | <p>shpërndara në semestra, të vlerësuara në kredite ETCS, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore në orë për Leksione, Seminare, Projekte, Detyra Kursi, Praktika, të parashikuara në planin mësimor. Një kredit ETCS i korrespondon 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit. Gjatë nje viti studimesh universitare, studenti me kohë të plotë fiton 60 kredite ose 1500 orë mësimore në auditor dhe orë pune te pavarur. Në Rregulloren e programit të studimit si dhe në syllabuset e lëndëve jepen të dhëna të detajuara lidhur me detyrimet e frekuentimit të lëndës nga studentët, si edhe rreth mënyrës së vlerësimit të dijeve.</p> <p>GVJ kostaton se sipas RVB-së, për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë-Kontabilitet” orët mësimore në auditor sipas viteve përkatësisht janë: viti i parë 645 orë, viti i dytë 735 orë dhe viti i tretë 614, pra janë tejkaluar në cdo vit orët që duhen zhvilluar në cdo vit akademik (1800 orë për të tre vitet). <i>GVJ gjatë vizitës në IAL pyeti Njësinë Bazë pse është kjo shpërndarje orësh mësimore dhe në total shkojnë 1994 orë mësimore në auditor. Zakonisht në të tilla programe studimi evidentohen nga 600 orë mësimore për çdo vit akademik dhe në total për tre vite akademike janë 1800 orë mësimore në auditor. Nuk pati ndonjë shpjegim përvec faktit se nuk ishin në kundërshtim me VKM nr.41, datë 24.1.2018.</i></p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>                                | <p>Të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, përshkruhen në Rregulloren e Programit të studimit.</p> <p>Në fillim të vitit, Fakulteti Ekonomisë, në UNIKO bën propozimin për kuotat e pranimit të studentëve në programin Bachelor në Financë Kontabilitet për vitin akademik pasardhës. Parashikimi i numrit të studentëve që do pranohen vitin pasardhës, mbështetet në Studimin<sup>49</sup> e tregut të punës, në analizën e prirjeve të regjistrimeve ndër vite si dhe bazuar në kërkesën e tërheqjes së studentëve nga tregu i punës çdo vit. Programi i paraqitet cdo vit palëve të interesuara, në rradhë të parë studentëve, përmes Praktikës së informimit të studentëve</p> <p>GVJ konstaton sipas dokumentacionit<sup>50</sup> të dorëzuar nga institucioni se studimi i fundit i tregut nga Departamenti i Financë Kontabilitetit është bërë në vitin 2018, sipas shtojcës 3.12.</p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit</p> | <p>Sipas kriterëve të mësipërme të këtij standarti, program i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, përmban informacionet e nevojshme për programet e lëndëve (syllabuset). Plani mësimor si një ndër elementet e programit të studimit përmbledh Lëndet/modulet, e për secilën lëndë: Leksione, Seminare, Projekte, Detyra Kursi, Praktika, si dhe gjithë komponentët formues të programit brenda e jashtë auditorit. Sipas RVB në këtë program studimi zhvillohen 22 lëndë e 37 module, ku përfshihen edhe Praktika profesionale dhe Teza e Diplomës.</p>   |

<sup>49</sup> Evidenca 3.12 Studim tregu pune periodik në kuadër hapjeje programi studimi.pdf;

<sup>50</sup> Evidenca 2.23 Kriteret specifike të tranferimit të studimeve dhe për program të dytë studimi.pdf; Evidenca 3.11 Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit.pdf; Evidenca 3.10 Praktika e promovimit dhe e informimit të maturantëve.pdf

| brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.  |  |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
|--|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| <b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Nga takimet me personelin akademik dhe sipas RVB-së rezulton se Fakulteti Ekonomisë në UNIKO, në fillim të vitit, risheh përmbajtjen e programeve të studimit për përmirësime e përditësime në përputhje me legjislacionin në fuqi, miraton ndryshimet duke ndjekur procedurat ligjore dhe i arkivon. Ndryshimet i bëhen të ditura gjithë drejtuesve të njesisë kryesore dhe të njesive bazë, me qëllim zbatimin e plotë të tyre. Procedura e përditësimit ndjek rrugën: departament, dekanat dhe më tej dërgohen për miratim në Senatën Akademik. |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>   | Nuk përmbushet       | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |  |  |  | X |
| Nuk përmbushet   | Përmbushet pjesërisht  | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |                      |                       |  |  |  |   |
|  |  |                      | X                     |                      |                       |  |  |  |   |

| <b>Standardi II.4</b>  |  |
|--|--|
| <b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b> |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.  | Sipas RVB-se e dokumentacionit <sup>51</sup> që është përcjellë nga IAL, DVV, si Shtojca 2.26 dhe 4.2 për ngarkesën totale në auditor, rezulton se ngarkesa e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, rezulton se respektohet ngarkesa ditore javore etj. në auditor, për të zhvilluar leksione, seminare, ushtrime, detyra, etj. Ora mësimore zgjat 50 min, rreth 4-5 ore mësimore në ditë ose 20-25 orë në javë. Ngarkesa për një vit akademik sipas VKM 41, datë 21.01.2018, për një vit akademik është 60 kredite (ETCS), mesatarisht 1500 orë, dhe nga këto jo më pak se gjysma duhet të jenë punë e pavarur e studentit. Ngarkesa e programit të studimit është e strukturuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Njesia bazë përcakton ngarkesën mësimore të cdo pedagogu në lëndën/t që do të mbulojë, përcakton ngarkesën e të gjithë njesisë bazë dhe e dërgon atë për miratim.<br>Në RVB saktësohet se në zbatim të standarteve më të mira, njesia bazë ka miratuar disa ndryshime në kurrikula në fillim të vitit akademik 2018-2019, duke zëvendësuar disa module, me module të reja më bashkëkohore, dhe bashkim të moduleve të të njejtës lëndë në një modul të vetëm, sipas shtojcës 2.25. Këto ndryshime konsiderohen brenda 20% të lejuar për t'iu miratuar brenda institucionit. |
| <b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.   | Sipas aktit të licensimit, Vendim Nr. 142, datë 04.08.1998 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në Kontabilitet, (Shtojca 2.7) emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve /moduleve dhe e praktikave, për këtë program studimi u mundëson studentëve marrje të njohurive, aftësive, kompetencave të duhura.  |

<sup>51</sup> Evidenca 4.2 Tabela e Ngarkesës së stafit akademik të programit të studimit.pdf;  
Evidenca 2.25 Relacion i ndryshimeve në Planin Mësimor.pdf;  
Evidenca 2.26 Kuadri i përgjithshëm formues i programit Bachelor Financë Kontabilitet.pdf;

|   |   |
|---|---|
|   | <p>Departamenti Financë Kontabilitet për realizimin e misionit e përgatitjes së brezave të profesionistëve në fushën e ekonomisë, përmes programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet”, përveç bashkëpunimeve me universitete të huaja, i kushton kujdes aktiviteteteve ekstrakurrikulare të studentëve si: vizita në kompani të ndryshme të sektorit publik; leksione të hapura me specialistë të njohur të fushave; pjesmarrje në konkurse të biznesit; organizim e pjesmarrje në konferenca shkencore në UNIKO e më gjerë. Të gjitha këto veprimtari në kuadrin e programit të studimit u krijojnë mundësi studentëve që pas përfundimit të ciklit të parë të gjejnë mundësi punësimi.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p> | <p>Sipas dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, GVJ-ja konstaton se UNIKO harmonizon shpërndarjen e lëndëve dhe praktikës mësimore në semestra për të arritur objektivat formues të programit të studimit për sa i përket rezultateve të të nxëniet dhe aftësimin profesional të studentëve. Këto rezultate të arritura për këtë program studimi, si në terma të mësimnxënies dhe në ato të aftësimin profesional bëhen cdo vit pjesë e analizave dhe raportimeve, sipas Analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>                   | <p>Organizimi i këtij program studimi (i sqaruar në kriteret më lart të këtij standarti) qysh në fillimet e tij është krijuar duke qenë në koherencë me kriteret e standartet institucionale dhe programore që aplikohen në tërë hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë. Sipas RVB-se programi i studimit respekton nivelin 6 të Kornizës shqiptare të Kualifikimeve dhe është i organizuar me 180 kredite. Struktura e programit të studimit merr parasysh dhe vlerëson dobinë që ka për studentët përmbajtja e lëndëve duke patur parasysh që studentët do të hasen në punën e tyre me situata nga më të ndryshmet, por edhe do punojnë në një ekonomi globale e konkurruese. Pra, dhe programet duhet t’i përshtaten këtyre zhvillimeve. Struktura e programit mësimor, ngarkesa e shprehur në kredite dhe raporti teori praktikë është në përputhje me profilet e programeve të përafërta të ngjashme ndërkombëtare në bachelor.</p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>                     | <p>Sipas dokumentacionit<sup>52</sup> të depozituar , raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Sipas RVB dhe Shtojcës 3.21, GVJ-ja konstaton se ky program studimi ndahet në veprimtari formuese të vendosura në raporte optimale në orë e kredite, njohuritë teorike e praktike, për të mundësuar aftësimin e studentëve, për arritjen e objektivave formues.</p> <p>Praktikat profesionale te studenteve dhe trainimet e tyre organizohen, ndiqen e mbikqyren nga komisioni i pedagogëve, të propozuara nga përgjegjësi i njesisë bazë e të miratuara nga dekani. Praktikat zhvillohen në institucione të caktuara, sipas marrëveshjeve të lidhura mes tyre dhe institucionit, ndiqen nga departamenti, përmes këshilltarëve të</p>  |

<sup>52</sup> Evidenca 2.18 Udhëzim nr 29 datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”.pdf; Evidenca 2.22 Kriteret e pranimit të studentëve.pdf; Evidenca 3.21 Udhëzuesi i praktikës.pdf; Evidenca 2.7 Plani Mësimor i programit të studimit.pdf; Evidenca 3.20 Udhëzuesi për përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës.pdf; Evidenca 3.22 Komisioni i mbikqytjes së Praktikave Profesionale.pdf;

|  |  |
|--|--|
|  | <p>departamentit për praktikat mësimore dhe vlerësohen me nota njëloj si detyrimet e tjera të studentit. Nëse i referohemi planit mësimor, praktika zhvillohet vitin e 3-të, vlerësohet me 6 kredite, e shprehur në orë është 150 orë punë nën mbikqyrjen e udhëheqësit të praktikës dhe punë e pavarur e studentit. Po kështu, ky program studimi mundëson edhe transferim të studimeve apo ekuivalentim të tyre, sipas kriterëve të përcaktuara nga MASR, por edhe të kriterëve specifike që propozon e miraton vetë IAL.</p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literature të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>                          | <p>Programet e lëndëve apo syllabuset të përfshira në këtë program studimi, përditësohen vazhdimisht veçanërisht për literaturën bashkëkohore të detyruar dhe ndihmëse, miratohen në departament para fillimit të vitit të ri akademik. Në këto kushte në fillim të çdo viti, personeli akademik<sup>53</sup> që do përfshihet në mësimdhënie ka detyrimin të dorëzojë syllabus të lëndës përkatëse, të përditësuar. Sipas Ligjit nr 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, propozimet bëhen nga njesia bazë, sic është rasti i syllabuseve, të cilat pasi diskutohen e miratohen në departament, përcillen për miratim në dekanat.</p> <p>Njesia bazë kujdeset që literatura si e detyrueshme dhe ndihmëse apo plotësuese të jetë sa më koherente. Në syllabuset<sup>54</sup> e lëndëve paraqitet literatura bazë dhe ajo plotësuese që duhet të shfrytëzojë studenti. Kriteri kërkon që literatura të jetë e 5 viteve të fundit, megjithatë GVJ gjykon se për një treg të vogël si vendi ynë, është pothuajse e pamundur që të bëhen ribotime librash çdo 5-vjet. Kështu, që GVJ gjykon si koherente literaturën e 5-8 viteve të fundit.</p> |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>                      | <p>Programi i studimit Bsc në Financë Kontabilitet në formë dhe në përmbajtje që nga viti i parë deri në vitin e tretë, bën harmonizim të mirë të dijeve dhe njohurive teorike me aftësimin praktik të studentëve. Kjo bëhet e mundur për arsye se personeli akademik i këtij program studimi kombinon teorinë me praktikën, përmes kombinimit të orëve të leksioneve e të seminareve, të formave të kontrollit të vazhdueshëm dhe të seancave të praktikave të zhvilluara në auditor, sjellja në auditorë e specialistëve të njohur të ekonomisë e financave për të sjellë eksperiencat e tyre; praktikat mësimore pranë bizneseve. Të gjithë këto veprimtari formuese, garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive e kompetencave që duhet të fitojnë studentët e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë Kontabilitet”</p>  |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>Sipas RVB-se dhe vizitës në institucion, si dhe dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, GVJ verifikoi se përmbajtja e programeve të studimit mundëson vazhdimin e studimeve apo edhe punësimin e studentëve për t’u përshtatur kërkesave të tregut, si u përmend edhe në kriteret e mësipërme të këtij standardi.</p> <p>Programi i studimit është ndërtuar në mënyrë të tillë që kombinon aftësimin teorik në lëndët e përfshira në program, me shprehitë praktike,</p>   |

<sup>53</sup> Aneksi II.10 Jetëshkrimet e stafit akademik BA, MNXH.pdf;

<sup>54</sup>Evidenca 2.8 Syllabuset 2019-2020.pdf

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | me shtrirje kohore, duke plotësuar një numër kreditesh, duke bërë të mundur vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë të studimeve.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Sipas RVB-se dhe vizitës në institucion, si dhe dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor “Financë Kontabilitet”, kombinon teorinë me praktikën më të përparuar të fushës së financës e kontabilitetit, bankave e institucioneve financiare, me qëllim përdorimin e aftësive të fituara në fakultet me eksperiencat nga praktikat mësimore në këto biznese.<br>Po kështu, nisur nga bashkëpunimi i UNIKO-së me mbi 45 institucione arsimore e me partnerë të biznesit, garantojnë praktikën profesionale, punësimi i studentëve të këtij programi studimi. Nënshkrimi i marrëveshjes me Universitetin e Tiranës, ka mundur shkëmbim të stafëve akademike, shkëmbim të programeve mësimore, por edhe bashkëpunimi për hartimin e programit të studimit sa më bashkëkohor. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

|  |  |
|--|--|
| <b>Standardi II.5</b>  |  |
| <b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>   |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.  | Sipas RVB <sup>55</sup> -se dhe vizitës në institucion, si dhe dokumentacionit <sup>56</sup> që është përcjellë nga IAL, DVV, GVJ verifikoi se personeli akademik i këtij programi studimi Bachelor në Financë Kontabilitet, qoftë ai efektiv apo me kontratë, i plotësojnë kërkesat ligjore në fuqi, në lidhje me plotësimin e kriterëve. Personeli akademik i këtij programi studimi ka shkallë të lartë kualifikimi dhe ka përvojë në mësimdhënie. Kualifikimet e personelit akademik janë në përputhje me lëndët që mbulojnë, referuar Shtojcës 2.9 e 2.27. Personeli akademik i Departamentit Financë Kontabilitet ka këtë përbërje: 14 personel akademik efektiv dhe 19 personel akademik i ftuar nga departamente të tjera. |
| <b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. |  |
| <b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e   | Bazuar në CV e personelit akademik rezulton që niveli i kualifikimit dhe fusha akademike kërkimore përputhet me vecoritë e moduleve që përmbledh ky program studimi. Personeli akademik i angazhuar për mësimdhënie në këtë program studimi, ka eksperiencë në fushën akademike, në kërkimin shkencor, janë ekspertë të fushës së financës apo   |

<sup>55</sup> Raporti i Vlerësimit të brendshëm.pdf

<sup>56</sup> Evidenca 2.9 Jetëshkrimet e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit.pdf; Evidenca 2.27 Jetëshkrimet e stafit ndihmës akademik të fakultetit. Pdf. Link 5.7 Kurrikulat (cv) e stafit; Evidenca 2.13 Organika e FE.pdf.



|  |  |                              |                             |  |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|--|
| studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.  | bankës, manaxherë, drejtorë drejtues biznesesh apo specialistë që punojnë ne biznese apo institucione.<br><br>GVJ-ja bazuar në RVB, vlerëson se personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet” në UNIKO, plotëson kriteret ligjore për kualifikimet në fushën akademike kërkimore të përgjithëshme dhe specifike.   |                              |                             |  |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Njesia bazë përgjegjëse për këtë program studimi përcakton një apo disa personel akademik si drejtues të praktikave mësimore për të ndjekur studentët gjatë gjithë kohës së kryerjes së praktikave. Si është përmendur në standartin II.4, Departamenti Financë Kontabilitet ka përcaktuar dy koordinatorë <sup>57</sup> , njeri prej të cilëve për programin bachelor. Ata koordinojnë punën mes departamentit dhe personelit akademik jo vetëm për ndjekjen e studentëve në praktikë, por edhe për punimin e diplomës apo veprimtari të tjera specifike. |                              |                             |  |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.  | Fakulteti Ekonomisë në UNIKO, sipas strukturës organizative, siguron e garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor e shkencor për realizimin e orëve të laboratorit dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mesimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. Angazhimi i personelit akademik dhe personelit ndihmës mësimor shkencor është i vazhdueshëm në funksion të realizimit dhe mbarëvajtjes së praktikave laboratorike dhe profesionale.  |                              |                             |  |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b><br><br><b>X</b> |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b><br><br><b>X</b> |

<sup>57</sup> Evidenca 2.11 Vendimi i njesisë bazë për emërimin e koordinatorëve të programit të studimit.pdf; 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale.pdf;

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| <b>Standardi III.1</b>   |  |
|--|--|
| <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>                                |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p> | <p>Duke iu referuar dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV, ne RVB dhe informacionit të marrë gjatë takimit ne UNIKO, GVJ konstaton se në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, paraqiten të gjithë elementët e mësimdhënies dhe kontrollit të dijes, përfshirë dhe metodat e mësimdhënies. Në varësi të specifikave të çdo lënde i gjithë personeli akademik nxitet të përdorë metoda bashkëkohore dhe inovative për realizimin e procesit mësimor, që nga përfshirja e të ftuarve specialë nga fusha të ndryshme, për tematika të vecanta, e deri tek përdorimi i videove me situata e koncepte specifike për të ilustruar çështje të caktuara. Studenti është në qendër të procesit mësimor, përmes zbatimit të këtyre metodave.</p> <p>Për t'iu përgjigjur situatës së pandemisë së Covid-19, UNIKO trainoi stafin për të përdorur platforma si EduMeet<sup>58</sup>, e në këtë mënyrë u zhvillua mësimi online pa ndërprerje e në zbatim të strukturës mësimore, për të gjitha lëndet e programet e studimit te FE, UNIKO.</p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>            | <p>Sipas takimit në institucion me Njesinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), konstatohet se kjo njesi funksionon<sup>59</sup> në bazë të Rregullores së drejtorisë kurrikulave, të Statutit të UK, e cila bashkërendon punën me departamentet përkatëse e strukturat e tjera brenda fakultetit që organizojnë kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësim nxënies në të gjithë elementet e tij si: në leksione, seminare, laboratorë dhe praktika mësimore. Disa instrumente të kontrollit e monitorimit të mësimdhënies e mësimnxënies janë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i mësimdhënies në auditor, nga anëtarët e personelit akademik të kategorisë lektor dhe asistente lektor nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani;</li> <li>• Hartimi i planit të punës për çdo personel akademik nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të vitit, duke e konsideruar si kontratë të performancës për personelin akademik. Mbi këtë bazë do të bëhet vlerësimi i personelit akademik në fund të vitit. Në këtë plan pune përfshihen të gjithë elementet e procesit mësimor, kërkimor e administrativ;</li> </ul> <p>NJSBC i paraqit rezultatet e monitorimit të performancës Senatit akademik me raportin e vlerësimit semestral.</p> <p>Për vlerësimin e performancës së personelit akademik i kushtohet rëndësi vlerësimit nga studentët, krahas vlerësimeve nga drejtuesi i departamentit.</p> |

<sup>58</sup> Evidenca 3.4 Manuali i përdorimit të aplikacionit EduMeet.pdf; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm .pdf,

<sup>59</sup> Evidenca 1.5 Rregullore e drejtorisë së kurrikulave (NJSBC, QKA).pdf; Evidenca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë.pdf; Evidenca 3.13 Pyetësor studentor fundkursi.pdf; Evidenca 4.8 Tabela e të dhënave për kualifikimin dhe kërkimin shkencor.pdf

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | Përmes sondazhit merret mendimi i studentëve për performancën akademike të personelit mësimdhënës.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.                                 | <p>Nga vizita në institucion rezultojnë se Departamenti i Financë Kontabilitet në UNIKO-se i jep rëndësinë e duhur përfshirjes së studentëve në manaxhimin e tërë procesit mësimor, veçanërisht në vlerësimin e cilësisë së procesit të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> <p>Përfshirja e studentëve realizohet përmes përfshirjes së tyre në plotësimin e pyetësorëve për vlerësimin e procesit të mësimdhënies, si edhe në procesin e diskutimit të rezultateve të kontrollit periodik të mënyrës së realizimit të leksioneve e seminareve, që realizohet nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me NJSBC, me pedagogët dhe studentët e grupit, një ose dy here në vit për çdo pedagog.</p> <p>Vlerësimet e studentëve për mësimdhënien në vitin akademik 2019-2020 është pozitiv.</p> <p>Ankesat e studenteve për rezultatet e vlerësimit në provime, mund të shqyrtohen sipas një shkalle hierarkie të caktuar në Rregulloren e FE.</p> |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.  | <p>Sipas Ligjit “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH” Nr 80/2015, për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies njihet si strukturë përgjegjëse NJSBC. Rregullat e detajuara të funksionimit të NJSBC përcaktohen në Statutin e UNIKO-së. Rezultatet e përpunuara të pyetësorëve, NJSBC-ja i dërgon të diskutohen në Departament, ku bëhet pjesë e analizës vjetore të procesit mësimor edhe rezultati i pyetësorëve, më pas diskutohet në Dekanat, Rektorat, e më pas ju komunikohen studentëve dhe personelit akademik problemet e evidentuara dhe masat që ka marrë Rektorati dhe Dekanati për të ardhmen. Kjo procedurë e ka rritur përgjegjësinë dhe cilësinë e punës së pedagogëve, të mësimdhënies, të infrastruktures, etj.</p>  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. | <p>GVJ u informua nga takimet me drejtuesit e UNIKO, me personelin akademik të njesisë bazë, se në mbledhjet ku analizohen rezultatet e anketimit<sup>60</sup>, diskutohen praktikat më të mira. Këto analiza ndihmojnë personelin akademik për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, për të përditësuar literaturën, për të përsosur mjetet që do përdoren për mësimdhënie, për të rishikuar strukturën e temave të çdo lënde, si dhe kërkesat për rritje të numrit të pedagogëve. Plani i hartuar nga njesia bazë për monitorimin e procesit të mësimdhënies, përmes vizitave në auditor është shembull i mirë, që ndihmon mësimdhënie cilësore, përgatitje të kujdesëshme të leksionit dhe të komunikimit me auditorin.</p>  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

|                 |                               |
|-----------------|-------------------------------|
| <b>Kriteret</b> | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b> |
|-----------------|-------------------------------|

<sup>60</sup> Evidenca 3.13 Pyetësor studentor fundkursi.pdf; Evidenca 3.14 Pyetësor i stafit akademik për mësimin online.pdf;

|  |  |
|--|--|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>  | <p>GVJ vëren se në format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë paraqitur në Rregulloren e programeve të studimit të UNIKO-së. Aty janë të përcaktuara elementët e studimeve dhe format kryesore të mësimin, në auditor si: leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, provimet pjesore, provimet përfundimtare, provimet e formimit, projektet e kursit dhe temat e diplomave.</p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> | <p>GVJ bazuar në dokumentat e depozituara<sup>61</sup> dhe në RVB, konstaton se personeli akademik i këtij programi studimi i përgjigjet nevojave të studentit dhe kushteve specifike (sic ishte rasti gjatë periudhës së pandemisë së Covid kur mësimi u zhvillua on line me platformën EduMeet). Personeli akademik duke marrë parasysh natyrën specifike të programit të studimit, ka përdorur metoda të larmishme të mësimdhënies edhe përmes rrugëve elektronike. Në Planin mësimor parashikohen lënde praktike që trajtohen në rrugë elektronike, si në vitin e dytë të studimit, lënda Informatikë, e cila zhvillohet në laborator. Po kështu, personeli akademik zhvillon edhe leksione, seminare në rrugë tradicionale. Përmes trajtimit teorik dhe nga pikpamja praktike të lëndëve u krijohet mundësia studenteve të njohin fushën e kontabilitetit, bankave, institucioneve financiare e në tërësi fushën e ekonomisë. Në RVB theksohet se mbetet e hapur mundësia që të përdoren edhe forma të reja të mësimdhënies për t’u përgjigjur kërkesave të studentëve e të tregut. GVJ nxit njesinë bazë të punojë më shumë në këtë drejtim.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>                     | <p>GVJ nga takimet me personelin akademik konstaton se UNIKO-ja e mbështet personelin akademik për të zhvilluar e përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme kompetencat didaktike. Është përmirësuar vitet e fundit mësimdhënien, duke krijuar mundësi të ushtrojnë lirinë akademike personelit akademik të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.</p> <p>Nisur nga ajo që paraqitet në RVB për mundësinë e përdorimit në të ardhmen të formave të reja të mësimdhënies GVJ nxit njesinë bazë të përdorë krahas metodave tradicionale edhe ato bashkëkohore si: video të shkurtra shpjeguese të koncepteve ose të rasteve studimore nga praktika, të përfshijë edhe më shumë lëndë apo module që zhvillohen në laborator si strategji e mësimdhënies përmes së cilës studentët mësojnë më mirë kur i praktikojnë vetë njohuritë e marra në auditor. Edhe eksperiencat e fituara përmes shkëmbimeve me universitete të huaja ndikojnë pozitivisht tek mësimdhënien, tek metodat e shumëllojshme e fleksibël pedagogjike.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të</p>  | <p>GVJ bazuar në RVB konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet” ka eksperiencën e duhur akademike, pasi në pjesën më të madhe janë ekspertë në fushën e tyre specifike për të cilën japin leksione e seminare. Personeli akademik jo vetëm ka eksperiencën e duhur akademike, por kanë edhe një bazë të</p>  |

<sup>61</sup> Evidenca 4.8 Tabela e të dhënave për kualifikimin shkencor.pdf; Evidenca 3.13 Pyetësori studentor fundkursi.pdf; Evidenca 2.5 Plani mesimor i programit të studimit.pdf; Raporti i vlerësimit të Brendshëm. pdf

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.  | mirë në ushtrimin e profesionit, në praktikën kombëtare e ndërkombëtare, duke e sjellë ekspertizën e tyre në auditor.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.                                      | GVJ bazuar në raportin RVB e në takimet në institucion, konstaton se në UNIKO diskutohet në mënyrë të vazhdueshme në njësitë bazë rreth përmirësimit të metodave të mësimdhënies, për të përfshirë sa më shumë studentët në diskutime. Personeli akademik i programit të studimit ka kualifikimin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi për përmirësimin e metodave të mësimdhënies e për t'i përfshirë studentët në këtë proces. Nisur nga dokumentacioni i dorëzuar rezultoi se 36% e personelit akademik është me titull Prof.As., 43% e tyre me gradën Doktor dhe 21 % e tyre janë Msc.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.  | Personeli akademik mbështetet nga universiteti dhe nxitet për të kualifikuar vazhdimisht, me qëllim që të sjellin në auditor metoda të reja të mësimdhënies e të përfshirjes së studentëve në këtë proces. Angazhimi i personelit akademik në programet e shkëmbimit të eksperiencave Erasmus + ka mundur rritjen e cilësisë së punës në auditor.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Zhvillimi i leksionit në mënyrë interaktive, është një metodë mësimdhënie e përdorur nga personeli akademik i programit të studimit.. Në UNIKO është në qendër studentit, për këtë arsye konceptimi i procesit mesimor është bere në këto funksion. Ka patur ndryshime nga metoda tradicionale e mësimdhënies, duke i dhënë me shumë mundësi pjesëmarrjes aktive të studentëve në auditor me pyetje e diskutime. Sjellja në auditor e profesionistëve të fushës për çështje të caktuara i afron studentet me realitetin e bizneseve tona. Edhe eksperiencat nga universitete të huaja, kryesisht mobilitete të pedagogëve me projekte Erasmus +, kanë nxitur të punuarit për metoda të reja të mësimdhënies.<br>Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, nxiti mendimin kritik të studentëve, përmes tërheqjes së tyre në diskutim gjatë zhvillimit të mësimin, përmes përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies. Kjo arrihet duke i dhënë detyra për të përgatitur në mënyrë individuale ose në grup studentëve dhe më pas i lihet kohë studentit apo grupit të studentëve të diskutojnë gjetjet e tyre në klasë. Nga takimi me studentet përforca mendimin se janë përdorur metoda të reja bashkohore mësimdhënie, që nxisin mendimin e pavarur, krijojnë lirshmëri në komunikimin me studentët. Edhe eksperiencat nga universitete të huaja kanë nxitur të punuarit për metoda të reja të mësimdhënies. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

### Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve  |
|---|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat | Veprimtaria mësimore e shkencore realizohet në disa godina të UK. Një pjesë e tyre janë të rikonstruara, disa janë ende në proces |

|   |   |
|---|---|
| janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.  | rikonstruksioni, në përfundim e sipër. UK dhe FE kanë hapësira <sup>62</sup> të mjaftueshme të pajisura me mjete dhe pajisje didaktike moderne. Godinat janë të pajisuar me sistem ngrohje ftohje në tërë ambientin. GVJ, megjithëse e zhvilloi vizitën në institucion online, për shkak të situatës së Covid 19, konstatoi se në UNIKO plotësohen kushtet për zhvillimin normal të mësimin dhe të gjithë aktivitetit kërkimor e shkencor.  |
| <b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.            | Sipas RVB dhe vizitës virtuale në institucion u verifikua se të gjitha sallat e leksioneve e seminareve janë të pajisura me kompjutera apo laptopë, e projektorë, tabela të ndryshme për të shkruar pedagogu apo studentët.<br><br>Krijohet mundësi për të zhvilluar mësimin me kompjutera për lëndë specifike si informatika, etj.<br><br>GVJ konstaton se mjedisi i bibliotekës ofronte hapësirën e duhur për libra e për të shtuar tituj të rinj për të cilët ka nevojë ky program studimi. UK dhe FE disponojnë Bibliotekat përkatëse Shkencore. Bazuar në dokumentat <sup>63</sup> e depozituara, Biblioteka e Fakultetit Ekonomisë disponon një sipërfaqe prej 100 m <sup>2</sup> me rreth 5400 tituj librash në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaj, për fusha të ndryshme të studimit që mbulon FE dhe programi i studimit Bachelor Financë Kontabilitet, sipas Shtojcës 4.10. Po kështu, studentët e personeli akademik mund të përdorin edhe librarinë elektronike (U LIBRARY), që mundëson gjetjen online të librave, revistave shkencore për përgatitjen e tyre. |
| <b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. | Sipas RVB UK përdor infrastrukturë të përshtatëshme IT, që u vjen në ndihmë studentëve dhe pedagogëve. Përmes saj informohen studentët online për vlerësimin e tyre të vazhduar dhe përfundimtar, pra komunikimi i studentëve me pedagogët kryhet në mënyrë elektronike. Shembull mund të merret sistemi elektronik <sup>64</sup> i vlerësimit të studentëve. Përmes kësaj forme rritet edhe përgjegjshmëria e pedagogëve për vlerësimin e studentëve dhe për ndjekjen me transparencë të gjithë procesit të vlerësimit.<br><br>Ky sistem mundëson në kohë reale lidhjen interaktive student/pedagog, sillabusin e lëndës dhe materialet mësimore të hedhura nga pedagogu (leksione, materiale të ndryshme), frekuentimin e studentit lëndë/module, vlerësimet e studentit (vlerësim i vazhduar dhe ai përfundimtar) etj. Edhe studentët kanë akses në çdo kohë në sistem për të parë informacion lidhur me vlerësimin, mungesat, detyrimet për çdo lëndë etj. Sistemi informatik <sup>65</sup> përdoret nga stafi akademik dhe studentët për kërkimin shkencor.          |
| <b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit  |   |

<sup>62</sup> Evidenca 4.7 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit.pdf;

<sup>63</sup> Link 5.20 "U- LIBRARY";

Evidenca 4.7 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit.pdf;

Evidenca 4.10 Të dhëna për fondin e librave në bibliotekë.pdf

<sup>64</sup> (<https://unikorce.esse3.u-gov.rash.al/Home.do>)

<sup>65</sup> <https://unikorce.esse3.u-gov.rash.al/Home.do>

|  |   |
|--|---|
| <p>të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>   | <p>Sipas kritereve 2,3 FE ka Bibliotekën e tij me numër të konsiderueshëm<sup>66</sup> titujsh në gjuhëshqipe dhe të huaj, mundëson edhe aksesin në libraritë online si për personelin akademik edhe për studentët. Stafi i bibliotekës ofron mbështetje studentëve për gjetjen e literaturës së duhur si për të studiuar edhe për punën e tyre kërkimore për përgatitjen e detyrave të kursit apo për diplomën në fund të ciklit të studimit.</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p> | <p>Në RVB shkruhet se studentët kanë akses të pakufizuar tek Libraria elektronike U-Library<sup>67</sup>, të cilën mund ta përdorin edhe duke përdorur telefonët e tyre celularë.</p>   |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>   | <p><i>Sipas komunikimit me pedagogët gjatë vizitës në IAL evidentohet se ka pasë vështrësi për të siguruar literaturën më të fundit për shkak të mos kryerjes së procedurave të tenderimit, pavarisht se IAL e kishte planifikuar fondin në dispozicion për blerje.</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>   | <p><i>GVJ nga RVB apo gjatë vizitës në IAL nuk konstatoi angaxhim të IAL-së për digjitalizimin e Bibliotekës. Sugjerojmë organeve drejtuese të UNIKO të mundësojnë digjitalizimin e Bibliotekës e cila do të mundësojë një përjasje moderne dhe akses online të studentëve dhe pedagogëve në literaturën bashkëkohore.</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>  | <p>Sipas minutave të takimit të GVJ dhe evidencës së depozituar nga institucioni, rezultojnë se FE ka një laborator të pajisur me rreth 30 kompjutera për të zhvilluar lëndët e informatikës, por jo vetëm, sipas programit mësimor. Laboratorët janë të pajisur me kompjuterë që kanë të instaluar softëare në përputhje me specifikat e programit të studimit Bachelor në “Financë- Kontabilitet”. Për përgatitjen e detyrave të kursit, projekteve, diplomave, studentët mund të përdorin kompjuterat që ndodhen në laboratorin e FE. Në RVB nuk përmendet kapaciteti që disponon FE në kompjutera. GVJ e mori këtë informacion në takimin që zhvilloi në institucion.</p>   |
| <p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>  | <p>Sipas kriterit 3 të këtij standarti, bazuar në RVB, dokumentacionin që është përcjellë nga IAL, DVV, rezultojnë se UK UK përdor infrastrukturë të përshtatshme IT, që u vjen në ndihmë studentëve dhe pedagogëve. Përmes saj informohen studentët on line për vlerësimin e tyre të vazhduar dhe përfundimtar, pra komunikimi i studentëve me pedagogët kryhet në mënyrë elektronike. Sistemi i shërben edhe personelit akademik për të hedhur nota, për të komunikuar e hedhur materiale për studentët, për të komunikuar me strukturat e UK.</p> <p>Për të mbështetur procesin mësimor në UNIKO kombinohet forma e mësimin në auditor me formën jashtë tij, përmes platformës së sistemit të teknologjisë elektronike “EduMeet”<sup>68</sup>. UK aplikon mësimdhënien në distancë, përmes platformës Google Classroom, Getiminigoogle, EduMeet, veçanërisht në periudhën e pandemisë së Covid-19.</p> |

<sup>66</sup> Evidenca 4.10 Të dhëna për fondin e librave në bibliotekë.pdf

<sup>67</sup> <https://unikorce.esse3.u-gov.rash.al/Home.do>

<sup>68</sup> Evidenca 3.4 Manuali i përdorimit të aplikacionit Edumeet.pdf; Evidenca 3.9 Manual përdorimi i faqes zyrtare të UK.pdf

|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | Përmes platformave studentët marrin informacion për mësimin, vlerësimin e provimeve, komunikojnë me sekretarinë, etj.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | Sipas RVB dhe takimit në institucion me personelin akademik dhe studentët rezultojnë se studentët orientohen nga pedagogët e tyre në përzgjedhjen e temave të diplomave, udhëhiqen prej tyre qysh në fillim për përcaktimin e strukturës së punimit të diplomës, deri në mbrojtjen e diplomës para komisionit të caktuar nga përgjegjësi i njesisë bazë e të miratuar nga dekan i FE. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                              | X                           |                              |

| <b>Standardi III.4</b>   |   |
|--|---|
| <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>  |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | GVJ-ja, bazuar në raportin RVB-se dhe dokumentacionin që është përcjellë nga IAL, DVV, konstaton se UK ka ngritur strukturën e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, Njesinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë NJSBC <sup>69</sup> në nivel institucional, e cila bashkërendon punën me njesitë bazë <sup>70</sup> . Në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Departamenti Financë Kontabilitet, në Fakultetin e Ekonomisë të UK, përcakton koordinatorët (Këshilltarët akademikë), të cilët në bashkëpunim me NJSBC mbikqyrin procesin mësimor. Përveç këtyre strukturave, kontrolli dhe mbikqyrja bëhen edhe nga njesia kryesore në bashkëpunim me NJSBC-në. Këto njesi bëjnë përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparura në mësimdhënie e mësimnxënie.<br><br>Të gjitha strukturat e UK mbështesin përmirësimet e vazhdueshme të mësimdhënies, përfshi metodat e reja inovative të tyre. |
| <b>Kriteri 2.</b> Njesia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.   | Departamenti Financë Kontabilitet është njesia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet” Këto përgjegjësi janë përcaktuar në Statutin e UK dhe në Rregulloren e Njesisë Kryesore. Njesia bazë është njesia ku nisen propozimet, pasi diskutohet, për çdo element që ka lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së programit të studimit. Njesia bazë dhe strukturat e tjera të UK studentët të jenë pjesë e procesit të evidentimit dhe përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.  |
| <b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.   | Njesia bazë ka rolin kryesor në promovimin e mbështetjen e metodave të reja inovative të mësimdhënies, por duke u mbështetur edhe nga strukturat e tjera në nivel fakulteti. Të gjitha strukturat e Fakultetit të Ekonomisë dhe të UK, duke ndjekur e zbatuar politikën e strategjitë e tyre inkurajojnë personelin akademik të zhvillojë metoda të reja mësimdhënie. Në lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, këto metoda fokusohen  |

<sup>69</sup> Evidenca 1.16 Manuali i cilësisë i UK.pdf;

<sup>70</sup> Evidenca 3.8 Analiza vjetore e njesisë bazë.pdf;



|  |   |
|--|---|
|  | <p>kryesisht në kryerjen e leksioneve nga specialistët më të mirë të fushës nga brenda apo jashtë fakultetit, nxitjen e punës në grup të studentëve, në analizën e rasteve studimore etj. Nga ana tjetër personeli akademik mund të zhvillojë mësimin me anë të mjeteve vizuale, laboratorëve, për të ndihmuar mësimdhënien e lëndëve specifike që kërkojnë përdorimin e teknologjisë.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>                            | <p>Personeli akademik i programit të studimit, plotëson kriteret për kualifikim si përmes kërkimeve e studimeve brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit. Sipas RVB fq 25, kualifikimi jashtë vendit kryhet përmes studimeve kryesisht afat shkurtër si dhe përmes programeve të mobilitetit të pedagogëve. Për këtë qëllim UK ka lidhur marrëveshje me organizata e universitete të ndryshme ndërkombëtare dhe ka realizuar projekte mobiliteti, përmes programit ERASMUS+. Njesia kryesore e njesia bazë kanë organizuar edhe aktivitete kërkimore shkencore si seminare e konferenca.</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njesitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>                               | <p>Sipas RVB-së, i gjithë personeli akademik i këtij program studimi, i është i përditësuar me metodat e reja inovative të mësimdhënies, të cilat i pasqyrojnë në përmirësimin e kurrikulave, por edhe të metodave të mësimdhënies. Personeli akademik përfshin në projekte kërkimore të fushës së financës apo kontabilitetit edhe studentët. Përdorimi i plotë ose i pjesshëm i të dhënave që përftohen nga puna e përbashkët me studentët për përgatitjen e punimeve shkencore që paraqiten në konferenca shkencore apo në punimet e diplomave është metodë e suksesëshme e mësim dhënies /mësimnxënies që inkurajohet nga Departamenti i Financë Kontabilitetit. Gjatë këtij procesi përmirësimi ata mbështeten nga njesitë bazë dhe hallkat e tjera të strukturës organizative të njesisë kryesore apo në nivel institucioni. Në shërbim të këtij procesi përditësimi kanë qenë dhe aplikimet për projekte që kanë patur si qëllim shkëmbimin e stafit dhe të studentëve. Në kriteret mësipër u përmendën platformat që u krijojnë mundësi pedagogëve dhe studentëve për mësim të personalizuar.</p> |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> | <p>Angazhimin për zbatimin e programeve të studimeve, për përmirësimin e mësimdhënies e përdorimin e metodave të reja, personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet”, e fillon me nënshkrimin e kontratës së punës nga UK.</p> <p>Sipas RVB-së, dhe dokumenteve të tjera si Raporti vjetor i aktivitetit mësimor kërkimor, gjetja e përdorimi i metodave të reja të mësimdhënies janë përparësi për të gjitha strukturat e UK, në vecanti për NJSBC<sup>71</sup>. Për të përmirësuar punën, janë organizuar seminare, leksione të hapura, konsultime, workshope etj. Këto metoda të reja janë bërë të njohura për të gjithë stafin e UK me qëllim gjetjen e mbështetjes nga të gjitha strukturat për të realizuar këtë objektiv. Nga vizita virtuale në institucion u informuam se në periudhën e pandemisë Covid – 19, përmes teknologjive e platformave të përshtatëshme personeli akademik e ai ndihmës akademik, iu përgjigjen mësimdhënies online, në përputhje me strukturën mësimore të miratuar.</p>  |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet</p>                 |   |

<sup>71</sup> Evidenca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njesisë bazë.pdf; Evidenca 1.5 Rregullore e drejtorisë së kurrikulave (NJSBC,QKA).pdf;

|  |                       |                              |                             |                              |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.     |                       |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |                       |                              |                             | X                            |

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve   |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.  | GVJ-ja konstaton, pas shqyrtimit të dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV dhe vizitës në institucion, se kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale vendosen në: Rregulloren e përgjithëshme e UK, Rregulloren e Provimeve, Rregulloren për Programin e Studimit. Në rregulloren e provimeve përcaktohet sistemi i vlerësimit me notë të studentit, dhe shërben si orientim për strukturën e këtij vlerësimi. Studentët njihen me rregulloren qysh në fillim të vitit akademik, duke mësuar të drejtat dhe detyrimet e tyre.  |
| <b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në syllabuset <sup>72</sup> e lëndëve përcaktohet në mënyrë të detajuar struktura e vlerësimit të secilës lëndë. Sistemi specifik i vlerësimit për çdo lëndë i bëhet i ditur studentit qysh në orën e parë të prezantimit të lëndës nga pedagogët, së bashku me elementet e tjerë të zhvillimit të lëndës si: detyrat e kursit, testi i ndërmjetëm, testi përfundimtar, vlerësimi me pikë i çdo detyrimi etj. Ky informacion për vlerësimin e lëndës saktësohet edhe në Rregulloren e UK, Rregulloren e Programit të Studimit, Rregulloren e provimeve. Nëse i referohesh një syllabusi vëren se bëhet një ndarje e vlerësimit të lëndës 20-30% vlerësimi i vitit, pjesmarrja, detyra etj., dhe Provimi përfundimtar 70-80% të pikëve. Ky informacion i jepet studentëve nga lektori i lëndës në leksionin e parë të asaj lënde.                                     |
| <b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.                            | GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit që është përcjellë nga IAL, DVV dhe vizitës në institucion, konstaton se për të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, struktura e vlerësimit të tyre është e përbërë nga disa elemente si: pjesmarrja aktive, provime të pjesëshme, paraqitje të detyrave apo gjetjeve në klasë, projekte individuale apo në grup, provime përfundimtare etj. Struktura mund të ndryshojë nga lënda në lëndë në varësi të specifikave të saj. Në çdo rast, struktura e lëndës mundëson vlerësimin e studentëve bazuar në disa elemente në përputhje me Rregulloren për programet e studimit, duke i dhënë mundësi studentit të tregojë njohuritë e marra dhe kompetencat e fituara. Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, pohime, pyetje shpjeguese, kuptim e zberthim konceptesh, ushtrime e raste. |

<sup>72</sup> Evidenca 2.8. Syllabuse 2019-2020 BA FK.pdf

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|                                     |                |                       |                      | X                     |

| Standardi III.6<br>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..  |  |
|--|--|
| Kriteret   | Vlerësimi i ekspertëve   |
| <b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.  | GVJ konstaton nisur nga RVB-ja se kontrolli i dijeve për çdo lëndë është i vazhdueshëm, duke e mbajtur studentin të angazhuar gjatë gjithë procesit të zhvillimit të lëndës. Vlerësimi final i tij përbëhet nga tërësia e vlerësimeve të vazhdueshme të bëra gjatë vitit përmes testeve apo projekteve finale sipas specifikave të lëndës. Ky vlerësim zakonisht përbëhet nga: 5 % për pjesmarrjen, 5% për aktivizim, 10% detyra kursi, dhe 10% provim i ndërmjetëm, provimi përfundimtar zakonisht është 70%. Të gjitha detyrimet përfshihen në programin apo syllabusin e lëndës.<br><br>Ky sistem i vlerësimit të njohurive të studentëve, i nxit e i motivon studentët të përgatiten në vazhdimësi, gjatë gjithë vitit, në auditor dhe në mënyrë të pavarur.   |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.   | Kriteret, kërkesat dhe procedurat që shërbejnë për testimin e aftësive të studentëve parashikohen në Rregulloren e UK dhe rregulloret e tjera në plotësim të saj. Në vazhdim të kriterit 1, në ato lëndë në të cilat është e mundur, realizohet testimi i studentëve në mënyrë elektronike si në: Informatikë apo lëndë të cilat mund të testohen me alternativa. Në pjesën më të madhe të lëndëve që zhvillohen në këtë program studimi mësimi zhvillohet nga të paktën dy pedagogë, për leksionin e seminarin dhe si rrjedhim edhe komisionet që testojnë njohuritë e studentëve janë me të paktën dy pedagogë, ku njeri është titullar i lëndës.<br>Sipas RVB, pikët e vlerësimit të vazhduar hidhen në sistemin ESSE dhe ruhen nga sistemi edhe në sezonet e tjera të provimeve nëse studenti nuk merr notë kaluese gjatë sezonit të rregullt.<br>Testi dhe vlerësimi përfundimtar i njohurive, aftësive dhe kompetencave realizohet nga komisionet e provimeve të ngritura nga njesitë bazë dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit, sic parashikohet nga Rregullorja e UK, Rregullorja e programit mësimor. |
| <b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.                            |  |
| <b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. | Testimi i studentëve, kur bëhet me anë të provimit me shkrim bëhet i sekretuar. Sipas RVB, kontrolli i testeve e provimeve zhvillohet sipas rregullave të parashikuara në Rregulloren e Njesisë bazë. Format e kontrollit parashikohen në këtë rregullore në mënyrë të detajuar dhe zbatohen me kujdes. Teza përgatitet nga titullari i lëndës dhe asistenti ose një anëtar tjetër i komisionit. Tezat sekretohen nga sekretaria me barkod dhe kontrollohen nga pedagogu pa emra. Pedagogu shpall rezultatet dhe sekretaria identifikon emrin me rezultatin në fletën e provimit. Provimi nuk zhvillohet asnjëherë pa sekretim, në disa salla ka edhe kamera për monitorim të procesit provimit. UNIKO-ja përdor dhe sistemin Clean Score për korrigjimin automatik të provimeve, rezultati del në pak minuta.   |

|   |  |                              |                             |                                    |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------------|
| <p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>Vlerësimi i njohurive, i dijeve i aftësive profesionale, bëhet bazuar në Rregulloren e UNIKO, në Rregulloren e provimeve. Pavarësisht formës së testimit, studentët kanë të drejtën e ankimit të rishikimit të procesit të vlerësimit. Sipas RVB, nga kontrollat që bëhen gjatë vitit, studentëve u jepen detyra që synojnë të përmirësojnë njohuritë që janë konstatuar të mangëta në provime.</p>   |                              |                             |                                    |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>  | <p>Sipas Rregullores provimeve, në UK procesi i provimit monitorohet nga komisioni i provimit, duke mos lejuar kopjimin e provimeve. Gjithashtu, personeli akademik i cdo lënde është i kujdesshëm për të eliminuar këtë problem edhe në detyrat apo projektet e kursit. Sipas RVB, njësitë bazë dhe personeli akademik respektojnë Rregulloren e Njesisë kryesore dhe Kodin e Etikës lidhur me mënyrën e mbikqyrjes dhe të masave ndeshkuese në rast kopjimi gjatë procesit të provimit ose plagjiaturës në rast kopjimi të projekteve të kursit etj.</p>   |                              |                             |                                    |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>   | <p>Nga minutat e takimit në institucion, u njohëm me faktin se korrigjimi i provimeve kryhet nga pedagogu/ët e lëndës, brenda një afati si rregull, 8 ditë nga dita e provimit dhe rezultatet dorëzohen në sekretarinë mësimore. Sipas RVB, pikët hidhen në sistem nga pedagogët brenda 8 ditëve nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim. Nga momenti i marrjes rezultatit studenti ka të drejtë që brenda 2 ditëve të kërkojë sqarime lidhur me rezultatin ose të kundërshtojë vlerësimin e marrë në provim. Komisioni i provimit duhet të sqarojë studentin lidhur me vlerësimin e bërë. Pas përfundimit të afatit dy ditor të ankimit, pedagogët kanë detyrimin të vendosin vlerësimin përfundimtar dhe të mbyllin procesverbalet. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit, teza depozitohet në departament.</p> |                              |                             |                                    |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>   | <p>Sipas Rregullores<sup>73</sup> për Programin e Studimit, studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit të provimit brenda një afati 48 orësh nga marrja e rezultatit të provimit Mbas kësaj faze nëse studenti nuk bindet, atëherë ka të drejtën e ankimit në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet nga një komision i vecantë.</p>   |                              |                             |                                    |
| <p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>  | <p>Cdo kërkesë apo ankimim shqyrtohet nga komisioni fillestar prej të paktën dy pedagogësh, duke respektuar Rregulloren e njesisë kryesore dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në UK.</p>  |                              |                             |                                    |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përmbushet</p>  | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht<br/>X</p> |

<sup>73</sup> Evidenca 2.5 Rregullore e programit studimit.pdf

| <b>Standardi III.7</b>   |   |
|--|---|
| <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>    |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.                                    | Sipas RVB programi i studimit Bachelor në “Financë Kontabilitet” krijon mundësin për formim bashkëkohor të studentëve. Programi zhvillohet në funksion të marrjes së njohurive të specializuara e bashkëkohore në fushën e Financës e Kontabilitetit.   |
| <b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti pas përfundimit të cdo lënde, evidentohen në fund të lëndës, kur studenti dorëzon detyrën e kursit apo projektin, apo nëse e mbron lëndën me provim me shkrim, ku studenti duhet t'i përgjigjet pyetjeve jo vetëm teorike, por edhe rasteve studimore. Në këtë mënyrë vlerësohen aftësitë e kompetencat e fitura nga studenti.  |
| <b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.                         | Sipas RVB, në përfundim të cdo lënde nga personeli akademik zhvillohet një leksion përmbyllës, ku përmbledhen të gjitha temat, duke shpjeguar çështjet kryesore. Studentët pyesin për paqartësi lidhur me lëndën, pedagogu orienton studentët për përgatitjen e provimit. Për cdo lëndë shpallet orari i konsultimeve të studentëve me pedagogët.   |
| <b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.   |   |
| <b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.                                    | Nga RVB-ja dhe takimi me personelin akademik GVJ mësoi se personeli akademik në orët e leksionit fton specialistë nga fushat e financës, teknologjisë së informacionit, ekonomisë në tërësi për të shpjeguar mbi zhvillime të reja të shkencës apo teknologjisë, në shërbim të ekonomisë. Gjatë gjithë vitit akademik zhvillohen seminare të hapura për tema e zhvillime të reja që kanë lidhje me fushën e financave, kontabilitetit, në të cilat kërkohet pjesëmarrja e studentëve. Studentët e programit të studimit Bachelor në “Finance Kontabilitet”, shfrytëzojnë këto leksione të hapura, për të plotësuar njohuritë e tyre mbi zhvillimet e reja në fushën përkatëse. Krijohen mundësi për studentët për kryerje praktikash mësimore, për mundësi punësimi në bizneset që janë ofruar për bashkepunim. |
| <b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.                                    | Nga takimi me personelin akademik GVJ mësoi se harmonizimi i formimit teorik me aftësimin e njëkohshëm praktik, me zbatimin në laborator të njohurive të marra në lëndë specifike, mundësojnë jo vetëm lidhjen me praktiken profesionale, por edhe punësimin e studentëve.  |
| <b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe  | Interaktiviteti, bashkëveprimi me studentët është proces që zhvillohet vazhdimisht në disa lëndë nga personeli akademik, duke dhënë detyra apo raste studimore që nxisin punën e pavarur, përdorimin e laboratorëve. Si   |

|   |   |
|---|---|
| <p>zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>  | <p>shembull mund të merret zgjidhja e situatave reale në lëndën e informatikës.</p>   |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p> | <p>Në UNIKO personeli akademik përdor si një nga metodat e mësimdhënies diskutimin në grup në orët e mësimi. Kjo rezultoi një mënyrë efektive për t'i aktivizuar studentët gjatë zhvillimit të mësimi në auditor. Sipas RVB në Strategjinë e UK përcaktohet se procesi mësimor zhvillohet me në qendër studentin. Nga dokumentacioni që është përcjellë nga IAL, DVV, dhe takimet me personelin akademik rezultoi se personeli akademik komunikoi në mënyrën e duhur me studentët, duke u përparuar të tërheqë vëmendjen e studentëve gjatë leksionit, përmes videove, rasteve studimore nga praktika, drejtimet të pyetjeve dhe marrjes së përgjigjeve, vlerësimit të tyre. Aktivizimi i studentëve mund të arrihet edhe përmes dhënies paraprakisht të leksionit studentëve për ta studiuar e më pas diskutohet në auditor, përmes përgjigjes së pyetjeve e përqëndrimit në çështjet më të rëndësishme. Personeli akademik nxiti idetë e reja, inovative të studentëve duke i mbështetur ata në idetë e tyre për punime kërkimore, apo për t'i paraqitur ato punime në konferenca shkencore. Edhe sjellja në auditor e specialistëve të fushave të ndryshme vendas apo të huaja, në përputhje me temën që do shpjegohet sipas programit, i shërben marrjes së njohurive të reja nga praktika e bizneseve, organizatatave etj.</p> |
| <p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>                     | <p>Në Rregulloren e UK, në raportin për metodat inovative në procesin e mësimdhënies, theksohet se studenti është subjekt i punës kërkimore shkencore, që kryen aktivitet krijues krahas personelit akademik. Studentët kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve kombëtare e ndërkombëtare si dhe pranë UK, për financime të veprimtarive kërkimore shkencore me logon e UK. Universiteti i Korçës falë marrëveshjeve të lidhura me institucione qendrore, lokale, universitete të huaja, biznese, mundëson nxitjen e këtyre ideve të studentëve. UNIKO ka vënë në dispozicion të kërkuesve për të realizuar punët kërkimore, salla e ambiente të ndryshme laboratore informatike, si dhe bibliotekën.</p>  |
| <p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>                    | <p>Sipas RVB e vizitës në institucion rezultoi se personeli akademik në UK punon për të përmirësuar format e mësimdhënies me qëllim rritjen e efikasitetit të mësimdhënies e mësimnxënies. Kjo arrihet duke rritur cilësinë e personelit akademik, por edhe duke bashkëpunuar me fakultete, biznese, institucione, për të shkëmbyer ekspertizë. Edhe bashkëpunimet me universitete jashtë vendit, edhe përprojekjet për të shkruar projekte e për të fituar projekte i shërbejnë përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, shtimit të mobiliteteve të pedagogëve e të studentëve për të marrë eksperiencë që do i ndajnë në auditorë.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit që disponon UK për pjesëmarrjen në projekte të huaja, nga faqja e internetit<sup>74</sup> e UK rezultojnë pjesëmarrje në disa projekte, disa prej tyre të përfunduara e disa në proces, ku ka përfituar edhe Departamenti i Financë Kontabilitetit, personeli akademik e studentët. GVJ mendon se pjesëmarrja në projekte të huaja do rriste</p>   |

<sup>74</sup> <http://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor>

|                                     |   |                       |                      |                       |
|-------------------------------------|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|                                     | mobilitetin e studentëve dhe të personelit akademik, do ndikonte për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. |                       |                      |                       |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet  | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|                                     |   |                       | X                    |                       |

### Standardi III.8

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

| Kriteret   | Vlerësimi i ekspertëve   |
|--|--|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> | <p>Nga RVB evidentohet se diplomimi i studentëve në programin e studimit Financë Kontabilitet kryhet sipas procedurës së miratuar në Rregulloren e Njesisë Kryesore, por edhe në faqen zyrtare të universitetit: <a href="http://www.unkorce.edu.al">www.unkorce.edu.al</a>. Nga vizita në institucion, takimet me studentët e personelin akademik GVJ mësoi se studentët informohen paraprakisht për procedurën e diplomimit qysh në fillim të vitit akademik. Njesia bazë para se të nisë semestri i dytë i vitit të fundit, njofton studentët me email për t'i informuar për formën e diplomimit dhe afatet përkatëse.</p> <p>Në Fakultetin e Ekonomisë, studentët e Programit të studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet" në fund të studimeve të ciklit të parë, kanë mbrojtur të gjithë temë diplome.</p> <p>Departamenti Financë Kontabilitet në bazë të Rregullores së programit të studimit si Njesia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, udhëzon studentët për procesin e diplomimit. Në funksion të mbështetjes që u jepet studenteve, të cilët diplomohen me provim diplome, janë Rregullorja e Njesisë Kryesore, por edhe faqja zyrtare e universitetit<sup>75</sup>, cikli Bachelor.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>   | <p>Personeli akademik i programit të studimit, ndihmon dhe orienton studentët për mënyrën e zhvillimit të provimit për mbrojtje diplome. Sipas, udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur dhe afate të përafërta për realizimin e punës së tij. Studentët duhet të respektojnë afatet e vendosura për të mundur mbrojtjen e temës në sezonin normal të mbrojtjes diplomes.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>   |  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>  | <p>Sipas RVB-së, institucioni mund të asistojë studentët për kryerjen e testeve, mbledhjen e të dhënave, analizimin e tyre, duke përdorur mjediset e Fakultetit Ekonomik, UNIKO, në varësi të fushës së kërkimit. Të gjitha burimet didaktike, informatike, salla, biblioteka dhe specialistët e IT vihen në dispozicion të studentëve nëse do u nevojitet mbështetje për këtë çështje.</p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston</p>   |  |

<sup>75</sup> [www.unkorce.edu.al](http://www.unkorce.edu.al)

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Sipas Rregullores së Sekretarisë <sup>76</sup> , rezultojnë se në përfundim të mbrojtjes së provimit apo të diplomës, studenti vlerësohet me pikë nga komisioni përkatës i ngritur me vendim të Dekanit. Këto pikë konvertohen më tej në notë përfundimtare të vlerësimit, dhe përfiton kredite, qoftë të provimit apo të temës së diplomës.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.  |  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.   | Sipas nenit 91, të ligjit 80/2015 “Per Arsimin e Lartë dhe Kerkimin Shkencor ne RSH”, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni në web si: Rregullore e Njesisë Kryesore dhe dokumenta të tjera të referuara më poshtë, në përfundim të studimeve çdo student pajiset me diplomën dhe suplementin <sup>77</sup> e saj, ashtu sikurse janë të miratuara nga MASR.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.   | Nga vizita në sekretarinë e institucionit dhe nga dokumentat, sipas RVB, rezultojnë se përveç diplomës dhe suplementit, me kërkesë të studentit, atij mund t'i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar në UNIKO.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.  | Sipas vizitës në institucion, veçanërisht në Sekretarinë Mësimore, dhe dokumenta të tjera të institucionit në web, konstatojmë se institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit sipas legjislacionit në fuqi. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studenteve kryhen, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Sekretaria mësimore sipas legjislacionit në fuqi, sipas Rregullores së Sekretarisë së këtij institucioni, konfirmon rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | X                            |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              |                             | X                            |

<sup>76</sup> Evidenca 1.10 Rregullore e sekretarisë.pdf;

<sup>77</sup> Evidenca 2.6 Modeli i diplomës – suplementit të programit të studimit.pdf;



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA  
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

| <b>Standardi IV.1</b>   |   |
|---|---|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>  |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.</p> | <p>Referuar evidencave të depozituara nga GVB rezultojnë se Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit bazuar në nenin 4, pika c dhe neni 5, pika 3 e rregullores së kësaj drejtorie (<i>Evidenca 1.4</i>)<sup>78</sup> administron bazën e të dhënave mbi personelin akademik, ndihmës mësuesor shkencor dhe administrativ. Gjithashtu, kjo bazë të dhënash përfshin dhe dokumentacion mbi organikën e FE (<i>Evidenca 2.13</i>)<sup>79</sup>, për 3 vite akademike 2017-2018, 2018-2019 dhe 2019-2020, si dhe jetëshkrimet e stafit akademik që mbulon programin e studimit (<i>Evidenca 2.9</i>)<sup>80</sup> dhe atij ndihmësmësuesor dhe administrativ (<i>Evidenca 2.27</i>)<sup>81</sup> si dhe listën e personelit të punësuar pranë UNIKO<sup>82</sup>.</p> <p>Nga vizita e realizuar në IAL, dhe verifikimit të kryer rezultojnë se nga dosjet e personelit akademik të shqyrtuara (2 dosje), rezultuan se të dhënat në lidhje me titujt e fituar në kohë dhe karrierën përditësohen.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>  | <p>Bazuar në nenin 64, pika 1 të ligjit 80/2015, Kodin e Punës, nenit 40 të Statutit të UNIKO<sup>83</sup> (<i>Evidenca 1.1</i>), Nenit 32 të Rregullores të Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore e Shkencore të UNIKO (<i>Evidenca 1.2</i>)<sup>84</sup> dhe Udhëzimit të Rektorit të UNIKO, nr.594, dt.08.10.2018<sup>85</sup> "Për vlerësimin e kandidatëve që punësohen si personel akademik" (<i>Evidencën 1.13</i>) të depozituara nga GVB, rezultojnë se UNIKO ka të përcaktuara procedura e rekrutimit, e zhvillimit të konkursit si dhe ngritjen e Komisionit Ad Hoc i cili shqyrton pajtueshmërinë e dokumentacionit të depozituar nga kandidatët me kriteret e përgjithshme të përcaktuara në ligj dhe rregullore, kriteret bazë për rekrutimin e personelit të vendosur nga Senati Akademik i UNIKO, si edhe kriteret specifike të përcaktuara nga njësia bazë dhe të miratuara nga Rektori, si psh kriteri specialitetit të diplomës universitare dhe notës mesatare, i cili është edhe kriteri skualifikues. Procesi rekrutimit administrohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit. Ky Departament arkivon bazën e plotë të të dhënave dhe procedurave të punësimit, të kuadrit ligjor, të dokumentacionit përkatës dhe të marrëveshjeve të nënshkruara në përfundim të gjithë procesit.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>   |   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që</p>  |   |

<sup>78</sup> Rregullorja e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore Komunikimit dhe Promocionit gjendet në Evidenca 1.4

<sup>79</sup> Organika e Fakultetit të ekonomisë gjendet në Evidenca 2.13

<sup>80</sup> Jetëshkrimet e stafit akademik gjenden në Evidenca 2.9

<sup>81</sup> Jetëshkrimet stafit ndihmësmësuesor dhe administrativ gjenden në Evidenca 2.27

<sup>82</sup> Organigrama e Universitetit Fan S. Noli, shih Link 5.30 <https://unkorce.edu.al/sq/node/670>

<sup>83</sup> Statuti i Universitetit "Fan.S.Noli", miratuar me Urdhrin nr.56, datë 08.02.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, gjendet në Evidenca 1.1

<sup>84</sup> Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore e Shkencore të Universitetit " Fan.S.Noli" gjendet në Evidenca 1.2

<sup>85</sup> Udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik gjendet në Evidenca 1.13

|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Procedurat e përzgjedhjes në UNIKO janë të hapura, me konkurs dhe me objektiv përzgjedhjen e personave të kualifikuar që zotërojnë grada e tituj shkencorë. UNIKO për rekrutimin e personelit bën shpallje publike ( <i>Evidenca 1.1.</i> ) <sup>86</sup> të pozicionit të punës, dhe të kriterëve në Buletinin e Njoftimeve Publike ( VKM nr.176 dt.29.03.2006 “Për botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike”) si dhe në website e Universitetit. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                              |                             | X                            |

| <b>Standardi IV.2</b>   |   |
|---|---|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b> |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.                    | <p>Ndër vite, Senati Akademik dhe Këshilli Administrimit të UNIKO pavarishtë vështirësive në sigurimin e fondeve janë angazhuar herë pas here në meremetime dhe adaptime të hapësirave disponibël në funksion të nevojave të personelit akademik të tij me qëllim krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme për kryerjen e detyrave të tyre si në aspektin e kushteve por edhe të mundësive për të marrë informacionin e nevojshëm përmes internetit, bibliotekave dhe sistemeve të informacionit.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, për shkak sepse objekti ishte nën rikonstruksion nuk arritëm të konstatojmë nëse personeli akademik i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit kishte zyra të veçanta për cdo PAE apo ato ishin të grupuara. Megjithatë, siç na u shprehën përfaqësues të UNIKO secili prej tyre zotëron një post pune të pajisur me një PC ku mund të punojë në mënyrë të pavarur.</p> <p>Edhe mjediset ku zhvillohet mësimi, si auditore, laboratore dhe klasa ishin në rikonstruksion dhe kjo do të sillte përmirësime duke plotësuar kriteret e nevojshme për të zhvilluar procesin e mësimdhënies në mënyrë sa më cilësore, pavarësisht këtyre kjo ngelet për tu parë në të ardhmen.</p> <p><i>Në përfundim, GVJ nuk arrin dot ta vlerësoj këtë kriter të Standardit IV.2 gjatë këtij vlerësimi.</i></p> |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.                     | GVJ konstaton se UNIKO mbështet stafin akademik për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre përmes mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore e publikime në revista shkencore. <i>Megjithatë, akoma më shumë aktive duhet të ishte njësia bazë (DFK) por edhe vet pedagogët e këtij departamenti për përfshirjen në projekte ku mund të siguronin mbështetje të mëtejshme për zhvillimin e tyre profesional dhe kërkimor përmes përfshirjes së tyre në projekte shkëmbimi ndërkombëtare në mësimdhënie, kërkim dhe</i>   |

<sup>86</sup> Formati i shpalljes së vendit të lire, ngritjes së komisionit të rekrutimit dhe kriterëve jepet në Evidenca 3.18

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | <i>bashkëpunim me universitete dhe partnerë të tjerë perëndimor. Kjo ishte e evidentuar edhe nga GVB në RVB.</i>   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | <i>GVJ referuar RVB-së shprehet se nuk ka evidenca që mund të tregojnë se çfarë ka bërë UNIKO për organizimin e programeve specifike për nxitjen dhe aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjive të reja nga personeli akademik e personeli mësimor-shkencor.</i>   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.   | <p>Nga vizita në IAL, GVJ konstaton se përmbushja e objektivave të programit të studimeve të ciklit të parë Bachelor në “Financë-Kontabilitet”, stafi akademik i përfshirë në mësimdhënie dëshmon një angazhim optimal në arritjen e këtij qëllimi.</p> <p>Ndërsa, GVB në raportin e tij evidenton se <i>gama e mjeteve promovuese të aplikuara nga UNIKO duhet të zgjerohen më shumë.</i></p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              | X                           |                              |

|   |   |
|---|---|
| <b>Standardi IV.3</b>   |   |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit</b>   |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.  | GVJ referuar RVB-së dhe konstatimit nga vizitat në institucion shprehet se IAL disponon auditorë të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Studentët e programit “Financë-Kontabilitet” kanë në dispozicion një infrastrukturë të plotë fizike, didaktike dhe logjistike për të realizuar me sukses programin mësimor. Referuar Evidencës 4.17 nga GVB janë prezantuar të dhëna <sup>87</sup> për ambientet mësimore në funksion të studentëve, për procesin teorik dhe praktik, janë salla me hapësirë të mjaftueshme, të pajisura me mjete audiovizuale dhe infrastrukturën e nevojshme për këtë program studimi. |
| <b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | <i>GVJ gjatë vizitës në IAL evidenton se kapacitetet e auditorëve dhe sallat e leksioneve nuk ishin të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit që garantonin realizimin e procesit mësimor përmes përdorimit të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies. Për këtë arsye ishte mundësuar edhe kryerja e rikonstruksionit i cili ishte në proces e sipër.</i>   |

<sup>87</sup> Evidenca 4.7 Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit

|   |   |                                     |                                    |                                     |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> |   |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>  | <p>GVJ referuar takimit me Studentët nga vizitat në institucion shprehet se IAL për këtë program studimi disponon <i>vetëm një laborator të teknologjisë së informacionit me kapacitet prirës prej 25 studentësh</i>, i cili sipas tyre nuk mund të përballoj nevojat e studentëve dhe pedagogëve të këtij programi studimi. Gjithashtu, ata konfirmuan se <i>ky laborator nuk ishte i pajisur me programe profesionale sipas natyrës specifike të disa prej lëndëve të planit mësimor të këtij programi si për shembull, Alpha, Financa 5, SPSS, etj.</i></p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>                             | <p>Ndërsa lidhur me zhvillimin e praktikave profesionale, njësia bazë për zhvillimin e praktikës profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike nga studentët e këtij programi studimi sipas planit mësimor ka lidhur marrëveshje<sup>88</sup> (Evidenca 2.10) me biznese private, institucione, studio kontabiliteti, etj.</p> <p><i>Në përfundim, GVJ konstaton se studentëve nuk ju plotësoheshin kushtet e nevojshme për mundësimin e trajtimit të njohurive aplikative për lëndët e këtij programi mësimor në laboratore të pajisur me programe profesionale sipas natyrës specifike të disa prej lëndëve të planit mësimor të këtij programi si për shembull, Alpha, Financa 5, SPSS, etj.</i></p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>  | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|   |   |                                     | X                                  |                                     |

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve  |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> | <p>Sipas RVB, ky institucion ka Biblioteka me salla leximi, me personel në dispozicion të 2039 studentëve të rregjistruar dhe 195 pedagogëve duke krijuar mundësinë e aksesit pa pagesë dhe të barabartë nga ana e tyre. GVJ gjatë vizitës në institucion evidenton se UNIKO mund të evidentohet si një IAL që ka angazhimin maksimal në ofrimin e kushteve dhe mundësive për Bibliotekën me qëllim që studentët dhe pedagogët e këtij institucioni të kenë mundësinë për rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e kërkimit shkencor përmes literaturës në tekste e periodike në gjuhën shqipe</p> |

<sup>88</sup> Evidenca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

|  |   |
|--|---|
|  | e të huaj përmes regjistrimit të tyre në kartelat e regjistrimit por edhe literaturës në soft copy.   |
| <b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Sipas RVB, për këtë IAL biblioteka, shërben si sallë studimi me fonde të hapura dhe është e pajisur me logjistikën përkatëse si kompjutera, internet si dhe me sistem ngrohje në ndihmë të studentëve, për lexim, studim dhe fotokopje. Sipas të dhënave <sup>89</sup> të Evidencës 4.10, biblioteka e Fakultetit Ekonomik zotëron fond prej 5447 librash, ku 219 në gjuhën shqipe, 5228 në gjuhë të huaj, 40 fjalorë dhe 640 libra artistikë. Ato janë të klasifikuara sipas natyrës së departamenteve dhe fushave përkatëse të studimit, të tilla si libra për ekonomiksin, financë-kontabilitet, mikro dhe makro ekonominë, menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e projekteve, marketingun, turizmin, statistikën, etj.     |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.   | UNIKO, si të gjithë universitetet e tjera publike mbështur prej MASR ka mundur për stafin dhe studentët shërbimin e Bibliotekës <sup>90</sup> on-line "ULIBRARY" <sup>91</sup> pa pagesë për studentët dhe stafin akademik. Libraria është e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe pedagogët nëpërmjet laptopëve, tabletave, apo telefonave smart, kompjuterave.<br><br>GVJ nga RVB por edhe gjatë bisedës me punonjësit e Bibliotekës evidentoi se IAL përmes angazhimit të tij ka siguruar akses për 2039 studentë të rregjistruar dhe 195 pedagogëve mundësinë e aksesit pa pagesë dhe të barabartë nga ana e tyre. Atyre ju ofrohet mundësia për të lexuar dhe shkarkuar tekste pa pagesë, me ndihmën e një email dhe password. |
| <b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.  | Studentët mund të shfrytëzojnë dhe një pjesë të konsiderueshme të fondit të librave në bibliotekën shkencore të vendosur pranë Rektoratit. Biblioteka online në kuadër të zbatimit të projektit të digjitalizimit të bibliotekës, është pjesë e Planit Strategjik për Zhvillimin e Universitetit 2016- 2020 <sup>92</sup> .   |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.  | GVB evidenton se Fakulteti i Ekonomisë të Universitetit Fan S.Noli është bërë pjesë e bibliotekës elektronike të Institutit të Mikpritjes (Institute of Hospitality, IoH e-library ) në tetor 2014 shërbim i cili vazhdon të ofrohet edhe tani, i sponsorizuar nga fondacioni "La Fondation pour la Formation Hôtelière" duke u futur në skemën "Education Membership Scheme (EMS)" Sipas të dhënave <sup>93</sup> (Evidenca 5.39) studentët e këtij fakulteti mund të regjistrohen dhe të shikojnë e shkarkojnë materiale dhe libra fala. Gjithashtu, që prej Nëntor 2014, Fakulteti i Ekonomisë ka pasuruar bibliotekën e fakultetit me një fond prej 179 librash të dhuruar nga fondacioni "Fondation Nestlé ProGastronomia".      |

<sup>89</sup> Evidenca 4.10 Të dhëna për fondin e librave në bibliotekë (në funksion të programit)

<sup>90</sup> Linku 5.31 Manual përdorimi i librarisë elektronike. <https://www.youtube.com/watch?v=YNwvu5grF70>

<sup>91</sup> <https://ulibrary.rash.al/>

<sup>92</sup> Evidenca 1.3 Plani Strategjik për Zhvillimin e Universitetit 2016-2020

<sup>93</sup> Shih Linkun 5.39 Bibliotekës elektronike e Institutit të Mikpritjes

<https://www.instituteofhospitality.org/membership/who-are-you/college-university/education-membershipscheme-current-members/>

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <i>GVJ nuk konstaton në RVB ndonjë evidencë që IAL të ketë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të këtij programi studimi.</i>  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | GVJ verifikoi në ambientet e Bibliotekës dhe website të UNIKO dhe evidenton kujdesin e treguar në informimin e studentëve për oraret e studimit në Bibliotekë dhe stafi respektiv që është në dispozicion për të asistuar ata për çdo nevojë në Bibliotekën e UNIKO.<br><br>Gjatë vizitës në Bibliotekën e IAL, konstatuam se orari i funksionimit është 8.00-16.00 nga dita e hënë në të premte. Kjo bibliotekë funksionon në bazë të kartelave të regjistrimit. Studentët dhe pedagogët kanë kartelat e tyre personale në bibliotekë. Çdo student apo pjesëtar i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe komuniteti kanë të drejtë të bëhen anëtare të bibliotekës universitare.<br><br><i>GVJ konstaton orare studimi të kufizuara të bibliotekës dhe rekomandon që oraret e Bibliotekës të zgjerohen përtej orës 16:00 duke shkuar deri në orën 20:00 si edhe në ditën e Shtunë duke iu krijuar studentëve mundësinë e shfrytëzimit në një fashë më të gjerë orare duke ju vendosur në dispozicion studentëve jo vetëm në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor por edhe në përgjigje të nevojave për studim të zgjatur të tyre.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | X                            |

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

| Kriteret  | Vlerësimi i ekspertëve  |
|---|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Sipas RVB-së: “UNIKO disponon sisteme të integruara informacioni si bashkëpunues në projektin e RASH. Ky projekt garanton sisteme të menaxhimit gjithëpërfshirës të informacionit duke mundësuar sigurimin e informacionit strategjik, duke kombinuar aplikacionet kryesore administrative si: të mësuarit dhe studenti, kërkimi, burimet njerëzore, kontabiliteti, etj”.<br>UNIKO ka marrëveshje <sup>94</sup> me RASH (Evidencës 2.14) për menaxhimin e karrierës së studentëve që prej regjistrimit të tyre në këtë program studimi, transferimet, faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave, etj. Ndërsa UNIKO sipas (Evidencës 1.6) paraqitet se gjithë informacioni për studentët dhe aktivitetin e tyre administrohet nëpërmjet sistemit <sup>95</sup> ESSE3 që përfshin një sekretari elektronike të plotë. Gjithashtu, ESSE3 administrohet dokumentacionin e hartuar nga pedagogu për vlerësimin e studentëve. Ndërsa rregjistrat fizikë të pedagogut |
| <b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të                |   |

<sup>94</sup> Evidenca 2.14 Marrëveshje RASH për ESSE3

<sup>95</sup> Evidenca 1.6 Manual i sistemit elektronik ESSE3

|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| angazhuar në realizimin e programit.  | <p>kontrollohen nga përgjegjësi i departamentit dhe nga grupi i punës i ngritur nga Rektorati çdo vit akademik.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në IAL kërkoi të verifikojë nëse të dhënat për studentët e këtij programi regjistroheshin dhe mbaheshin në formë të shkruar në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, neni 101. Sipas pohimit të Kryesekretares dhe kontrollit, regjistrat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Regjistri themeltar të studentëve,</li> <li>Regjistri i arritjeve akademike ku hyn dhe procesverbali i çdo provimi apo detyrimi tjetër akademik,</li> <li>Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave.</li> </ol>   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.  | <p><i>Nga RVB nuk evidentohet që UNIKO të ketë një sistem të vetin të brendshëm për menaxhimin dhe administrimin e informacionit. Kjo nuk të mundëson të vlerësosh nëse UNIKO plotëson kriteret 3, 4 dhe 5 të këtij standardi. Gjithashtu, RVB nuk është shprehur për plotësimin e këtyre kriterëve në RVB, me përjashtim se sipas RVB-së: “Në hollin e godinës të fakultetit janë instaluar monitorë dhe stenda, në të cilët paraqiten në mënyrë të vazhduar njoftime dhe materiale që orientojnë, ndihmojnë dhe informojnë studentët. Informacioni për programin e studimit “Financë-Kontabilitet” është i publikuar në faqen e internetit të UNIKO <a href="http://www.uniko.edu.al">www.uniko.edu.al</a>, nënfaqja Programe Studimi Bachelor dhe nënfaqja Fakulteti i Ekonomisë”.</i></p> <p>Gjatë vizitës në IAL, GVJ verifikoi dhe evidentoi se UNIKO zotëron një faqe web<sup>96</sup> ku publikon informacione në gjuhën shqipe dhe angleze. Një pjesë e informacionit të publikuar lidhet me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, etj.</p> |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.                          |   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.     |   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. |   |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

<sup>96</sup> Website: <http://www.unkorce.edu.al>

**Standardi IV.6**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

**Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**


**Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.

**Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.

Sipas RVB-së, bazuar në nenin 84, të statutit<sup>97</sup> të UNIKO (Evidenca 1.1) hartimi i buxhetit të UNIKO fillon nga njësia bazë, Departamenti Financë-Kontabilitet për këtë program studimi. Në këtë fazë, merren parasysh nevojat financiare për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. Administrata e Universitetit, harton projekt buxhetin e njësive të tjera ndihmëse dhe së bashku me projekt buxhetet e njësive kryesore, harton projekt buxhetin e vitit respektiv e cila nga IAL është paraqitur si dokument (Evidenca 3.15)<sup>98</sup>. Gjithashtu, burimet financiare shpërndahen dhe përdoren sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit dhe realizohet në dy faza, hartimin dhe miratimin e buxhetit nga granti i pakushtëzuar që akordohet nga MASR dhe buxhetin nga të ardhurat e Universitetit bazuar në nenin 78 të statutit<sup>99</sup> të UNIKO (Evidenca 1.1). Në të përcaktohen edhe përparësitë që do të ketë në investimet e tre viteve të ardhëshme në përputhje të plotë me nevojat infrastrukturore dhe logjistike.

Ndërsa në gjysmën e dytë të çdo viti, bazuar në nenin 77 të statutit, UNIKO kryen procedurat për miratimin e projekt buxhetit afatmesëm (Evidenca 1.1), i cili mbështetet tek kërkesat e njësive kryesore dhe ndihmëse, për të cilin ndiqet e njëjta procedurë si edhe për hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor.

*GVJ bazuar në evidencën (të Shtojcës 3.15)<sup>100</sup> konstaton se kosto mesatare për student "Grant i Buxhetit të Shtetit" ka një tendencë rritje të dukshme për çdo vit akademik. Kjo paraqitet grafkisht në vijim bazuar mbi përpunimin e të dhënave.*



<sup>97</sup> Evidenca 1.1 Statuti i UNIKO Neni 84

<sup>98</sup> Buxhetet e UNIKO jepen në Evidenca 4.11

<sup>99</sup> Statuti i UNIKO Neni 78 gjendet në Evidenca 1.1

<sup>100</sup> Evidenca 3.15 Kosto mesatare për student




|   |  |
|---|--|
|   | <p><i>Sipas RVB-së, nuk evidentohet nëse UNIKO harton një plan financiar të dedikuar për këtë program studimi. Gjithashtu, gjatë intervistave në IAL nga GVJ u pyetën nëse kryejnë analiza për koston për student për këtë program studimi. Përgjigja ishte se ende jo.</i></p> <p><i>Në përfundim, GVJ konkludon se pavarësisht se UNIKO është një IAL publike, hartimi dhe miratimi i buxhetit të Universitetit duhet të mbështetet mbi analizën e koston për student për çdo program studimi e cila në vitin akademik 2018-2019 ka një rritje me rreth 50% krahasuar vitin akademik 2015-2016. IAL duhet të hartoj një plan pune me masa konkrete lidhur me adresimin e kësaj çështje përgjatë hartimit dhe miratimit të buxhetit të UNIKO në vitin e ardhshëm akademik.</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> | <p><i>Përgjigja e dhënë nga GVB nuk i jep përgjigje kriterit 3.</i></p> <p>Sipas RVB-së, UNIKO çdo vit dorëzon pranë MASR dhe Degës së Thesarit Korçë pasqyrat financiare vjetore të çdo viti. UNIKO në plotësim të nenit 85 të statutit<sup>101</sup> të tij, i nënshtrohet auditimit financiar që realizohet nga Auditimi i Brendshëm i MASR duke u bazuar në përcaktimet e bëra në dokumentat e brendshëm si dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Rezultatet e auditit financiar të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë publike në faqen zyrtare të KLSH-së<sup>102</sup> dhe webin e UNIKO.</p> <p>Sipas RVB-së, raportet e veprimtarisë financiare, raportet e KLSH-së, raportet e auditit të MASH-it dhe e auditit të Universitetit diskutohen me organet kolegjiale të Universitetit, si në Rektorat, Bordi i Administrimit (BA) dhe në Senatin Akademik. RVB nuk evidenton nëse UNIKO ka hartuar një plan masash për adresimin e rekomandimeve dhe evidenca progresive për follow up të secilit prej tyre.</p> <p><i>Gjatë vizitës në IAL, u pyetën nëse Njësia e Auditimit të Brendshëm ekziston dhe çfarë rekomandime ka dhënë për DFK dhe këtë program studimi përgjatë këtyre viteve. Përgjigja ishte se ende UNIKO nuk e kishte ngritur njësinë e Auditimit të Brendshëm. Referoju edhe argumentimit të dhënë me Dokumentin shtesë nr. 7 "Relacion për mungesën e plotësimit të AB" të depozituar pas vizitës së GVJ në IAL.</i></p> <p><i>GVJ, në përfundim rekomandon se UNIKO duhet të plotësoj me staf Njësinë e Auditimit të Brendshëm në zbatim të nenit 116 të Ligjit Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" me qëllim që kjo njësi të jetë funksionale dhe kryej detyrat e saj.</i></p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të</p>   | <p><i>Përgjigja e dhënë nga GVB nuk i jep përgjigje kriterit 4 dhe 5, kjo vjen si pasojë e mos pasjes së analizave dhe raporteve financiare për këtë program studimi.</i></p> <p>Ndërsa dihet se pjesa kryesore e financimit të UNIKO si një institucion publik mundësohet përmes: Grantit që akordohet prej MASR, ndërkohë që të dhënat nga regjistrimet e studentëve në vitet e para për këtë program mësimor janë si në vijim:</p>  |

<sup>101</sup>Statuti i UNIKO Neni 85 Evidenca 1.1

<sup>102</sup> Rezultatet e auditit gjenden në Linkun 5.32 [http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/transparenca/auditim\\_0.pdf](http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/transparenca/auditim_0.pdf)

garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.

**Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.



Pavarsisht se vihet re një rritje nga 64 studentë në vitin 2019-2020 në 68 studentë për vitin akademik 2020-2021, përsëri duhet të merren masa që tendencat për studentë të regjistruar në vitin e parë për vitet në vijim të mund të ruaj trendin rritës.

*GVJ konkludon se IAL duhet të marrë masa për llogaritjen e kostove për student në këtë program studimi me qëllim kryerjen e analizave të nevojshme për mirëmenaxhimin e fondeve të marra nga buxheti i shtetit dhe orientimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturën e UNIKO në arritjen e misionit të tij përmes analizës dhe përcaktimit të strategjive konkrete për çdo njësi bazë dhe program studimi.*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|                                     |                |                       |                      | X                     |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|   |                |                       |                      | X                     |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| <b>Standardi V.1</b>  |   |
|---|---|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>   |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislationin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.   | Sipas statutit <sup>103</sup> të UNIKO (Evidenca 1.1) bazuar dhe në dispozitat e Ligjit 80/2015, UNIKO ka përcaktuar procedurat dhe politikat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të këtij programi nga hyrja në dalje të tyre.<br><br>Rregullore e Brendshme e Fakultetit Ekonomik specifikohen gjithashtu rregullat e regjistrimit të studentëve, hartimit të planeve mësimore, struktura e vitit akademik, zhvillimit të provimeve, përgatitjes dhe shpërndarjes së diplomave etj. Gjithashtu, sipas rregullores <sup>104</sup> së programit të studimit (Evidenca 2.5) e mbështetur në kërkesat e ligjit 80/2015 përcaktohen gjithashtu edhe procedurat e tërheqjes së diplomës.  |
| <b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.   | Në zbatim të nenit 74, të Ligjit 80/2015, UNIKO ndjek procedurat dhe informon vazhdimisht palët e interesuara për aplikimin e sistemit online të ministrisë për maturën shtetërore. Lidhur me kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, në nenin 50 të statutit të UNIKO përcaktohet se pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, bëhet sipas kuotave të paracaktuara dhe është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson: -Kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. - Kriterin e rëndësisë (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, si dhe gruplëndët, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në UK) sipas përcaktimeve të njëjësive bazë. Në zbatim të sa më sipër Rektorati shpall me vendim kriteret e pranimit të studentëve në UK, i cili miratohet nga Senati Akademik, duke marrë në konsideratë vendimin për kriteret <sup>105</sup> të marrë nga njësia bazë (Evidenca 2.22), të tilla si kriteri specifik i notës mesatare të gruplëndëve të profilit (me një peshë 30%) të tilla si; matematikë, ekonomi, gjuhë e huaj dhe TIK). |
| <b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Në zbatim të nenit 74, të Ligjit 80/2015, UNIKO ndjek procedurat dhe informon vazhdimisht palët e interesuara për aplikimin e sistemit online të ministrisë për maturën shtetërore. Lidhur me kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, në nenin 50 të statutit të UNIKO përcaktohet se pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, bëhet sipas kuotave të paracaktuara dhe është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson: -Kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. - Kriterin e rëndësisë (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, si dhe gruplëndët, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në UK) sipas përcaktimeve të njëjësive bazë. Në zbatim të sa më sipër Rektorati shpall me vendim kriteret e pranimit të studentëve në UK, i cili miratohet nga Senati Akademik, duke marrë në konsideratë vendimin për kriteret <sup>105</sup> të marrë nga njësia bazë (Evidenca 2.22), të tilla si kriteri specifik i notës mesatare të gruplëndëve të profilit (me një peshë 30%) të tilla si; matematikë, ekonomi, gjuhë e huaj dhe TIK). |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.   | Këto kriteret, informacione <sup>106</sup> , rregullore, procedura, manuale, udhëzues, etj., për pranimin apo transferimin e studentëve të këtij programi studimi janë të publikuara per palët e interesuara në webin e UNIKO në seksionin e veçantë të departamentit si dhe të programit të studimit Financë-Kontabilitet, si p.sh udhëzuesi për përdorimin e sistemit dixhital ESSE3 <sup>107</sup> për studentët e regjistruar në këtë program (Evidenca 5.14; 1.6 ose 5.3). Gjithashtu, sekretaria e departamentit, së bashku me stafin e Departamentit   |
| <b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret  | Këto kriteret, informacione <sup>106</sup> , rregullore, procedura, manuale, udhëzues, etj., për pranimin apo transferimin e studentëve të këtij programi studimi janë të publikuara per palët e interesuara në webin e UNIKO në seksionin e veçantë të departamentit si dhe të programit të studimit Financë-Kontabilitet, si p.sh udhëzuesi për përdorimin e sistemit dixhital ESSE3 <sup>107</sup> për studentët e regjistruar në këtë program (Evidenca 5.14; 1.6 ose 5.3). Gjithashtu, sekretaria e departamentit, së bashku me stafin e Departamentit   |

<sup>103</sup> Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli"

<sup>104</sup> Evidenca 2.5 Rregullorja e programit të studimit

<sup>105</sup> Evidenca 2.22 Kriteret e pranimit të studentëve

<sup>106</sup> Evidenca 5.3 Informim mbi Programin e studimit, në linkun : <https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit-bachelor>

<sup>107</sup> Evidenca 5.14 Sekretaria Studentore Online në linkun <http://www.unkorce.edu.al/sq/node/661>; Evidenca 1.6 Manuali i sistemit elektronik ESSE3

|  |   |
|--|---|
| <p>parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>  | <p>në takimet me studentët e këtij programi i informojnë ata në lidhje me këtë sistem si dhe në lidhje me përshtatjen e tyre më mënyrën e organizimit dhe ecurisë mësimore, infrastrukturën, shërbimet dhe fasilitetet etj. Në mënyrë të shkurtuar studentët informohen përmes fletëve informuese për strukturën, organizimin dhe programin e studimit, të vendosura në stendat e FE-së.</p> <p>Sipas rregullores së Fakultetit Ekonomik (<i>Evidenca 2.5</i>) garantohet barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët duke mos lejuar diskriminime në bazë gjinie, origjine, etnie, apo shtetësie. Studimet në FE mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarët etnike jashtë kufijve shtetërore si dhe nga çdo shtetas i huaj, në bazë të kriterëve të përcaktuar nga MASR, statuti i UK-s dhe rregullorja e studimeve të FE, neni 35.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në sekretarinë e IAL-së u bë me dije se regjistrimi i studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Financë Kontabilitet” kryhej pranë tyre duke respektuar renditjen sipas listave të publikuara të studentëve fitues duke garantuar barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student.</p> <p>Për tu evidentuar është edhe konstatimi i kryer në verifikim e bërë në web të UNIKO ku gjenden të publikuara të gjitha kriteret dhe procedurat që kanë të bëjnë me: pranimin, përzgjedhjen e studentëve, përparimin përgjatë kursit të studimit, transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit për cilindo prej studentëve që ndjek ciklin e parë të studimeve Bachelor në “Financë Kontabilitet”.</p> <p>GVJ konstaton se UNIKO është kujdesur për hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit të studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Financë Kontabilitet”. Gjithashtu, pjesë e këtyre procedurave janë edhe kriteret e parashikuara dhe të publikuara nga UNIKO lidhur me regjistrimin e studentëve sipas kategorive në kuota të veçanta, përfshirë këtu edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p> |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> | <p>Sipas RVB konstatohet se UNIKO takimet me kandidatët për studentë të ardhshëm i kryen përmes vizitave në ambientet e gjimnazeve apo shkollave profesionale, e më gjerë, nën koordinim e strukturave të MASR. Në 2020 informimi i maturantëve u krye bazuar në udhëzimin e ri të MASR<sup>108</sup> si dhe bazuar në kalendarin e Këshillimit të Karrierës të dërguar nga Drejtoria e Arsimit Parauniversitar pranë MASR<sup>109</sup>. Në ambientet e UNIKO organizohen gjithashtu aktivitete “Open days” pranë mjediseve të UK dhe FE<sup>110</sup> në të cilat DFK shpalos ofertën e saj tek kandidatët potencial për student. Gjithashtu përveç se tek U-Albania, të interesuarit mund të gjenë informacion në web të UNIKO dhe rrjetet sociale rreth këtij programi</p>  |

<sup>108</sup> Evidenca 3.10 Praktika e promovimit dhe informimit të maturantëve

<sup>109</sup> Evidenca 4.12 Kalendarin e Këshillimit të Karrierës

<sup>110</sup> Evidenca 5.2 Fushata promovuese me maturantët, faqja në web: <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/uniko-zhvilloi-fushaten>

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <p>studimi, formulës së përlogaritjes së pikëve për maturantët që zgjedhin të vijnë në studimet e tyre në këtë program, etj. Nga ana institucionale sigurohet mirëmbajtjen dhe funksionimin normal i sistemit ESSE3 për pasqyrimin e çdo informacion të destinuar për t'u publikuar në internet në portalin e UK-së<sup>111</sup>.</p> <p><i>GVJ konstaton se pavarësisht përpjekjeve të bëra deri më tani, UNIKO duhet të jetë akoma më shumë e pranishme në medime të tjera komunikimi për të prezantuar arritjet e tyre si IAL në fushën e edukimit shkencor dhe sidomos kërkimit shkencor si edhe angazhimit të studentëve në këto projekte. Këto përcjellin imazh dhe reputacion të lartë për publikun duke influencuar edhe rritjen e kërkesës për regjistrime në këtë IAL. Në përfundim, lidhur me këtë standard GVJ konkludon se përveç kujdesit të treguar nga IAL për këtë standard, gjykon se nuk ka vend për risk material në këto kritere të trajtuara në këtë standard përderisa jemi në kushtet dhe rrethanat kur ky program studimi në këto vitet e fundit nuk ka arritur të plotësoj kuotat e miratuara.</i></p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

|   |  |
|---|--|
| <b>Standardi V.2</b>  |  |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b> |  |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.  | Bazuar në RVB dhe dokumentat shoqëruese evidentohet se Koordinatori i programit dhe Përgjegjësi i Departamenti Financë Kontabilitet kryejnë takime informues me studentët e këtij programi studimi që në javën e parë të mësimit. Studentët informohen mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, modulet, lëndët, përmbajtjen, kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, si edhe veprimtaritë formuese <sup>112</sup> .   |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.  | GVJ bazuar në RVB konstaton se në rregulloren e UK <sup>113</sup> gjendet informacioni në lidhje me procedurat e njohjes së kualifikimeve ose studimeve të pjesshme që ata mund të kenë realizuar në institucione të tjera të Arsimit të Lartë, programe të tjera studimi ose studime të kryera jashtë. Ndërsa vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve, me qëllim vazhdimin e studimeve, merret nga Komisioni i Ekuivalentimit të Njësisë Bazë. Ky komision merr në konsideratë edhe kriteret specifike për transferim dhe ekuivalentim të studentëve (Evidenca 3.24 "Model |

<sup>111</sup> Evidenca 5.3 Programi i studimit në linkun: <https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit>

<sup>112</sup> Evidenca 3.11 Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit

<sup>113</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore e UNIKO, Kreu VI, neni 79

|  |   |
|--|---|
|  | <p>propozimi nga njësia bazë e kriterëve specifike për transferimin, ekuivalentimin dhe vazhdimin e studimeve nga studentët”<sup>114</sup>).</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, grupi GVJ pyeti dhe u informua se në fillim të çdo viti akademik, DFK ngrinte një komision ad-hoc për njohjen e lëndëve dhe krediteve respektive bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga sekretaria mësimore për studentët e interesuar.</p> <p>Nga verifikimi i kryer nga GVJ në website të UNIKO (respektivisht në disa links<sup>115</sup>) dhe llogaritë zyrtare të krijuara nga QKA në rrjetet sociale konstatohet se të gjithë studentët e interesuar mund ta gjejnë lehtësisht dhe vazhdimisht informacion mbi çështje të rëndësishme të studentëve që lidhen me veprimtarinë e tyre akademike, të tilla si pranimet, procedurat e rregjistrimit, tarifat, transferimi i studimeve, mobilitetet, këshillin e studentëve, veprimtari, njoftime, etj.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> | <p>Pavarsisht se GVB ka cituar se kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentëve në programin e studimit përcaktohen mjaft qartë në rregulloren e FE, GVJ konstaton se në RVB nuk janë cituar nenet respektive të kësaj rregullore si edhe nuk është shtuar kjo si evidencë.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në IAL kërkoi të verifikoj këtë evidencë nëse ajo përmban kërkesa rregullatore për format e kontrollit të dijeve të tilla si: mbrojtja e projekteve të kursit, ushtrimeve në laborator, testimet ndërmjetëse, mbrojtja e praktikave mësimore, provimet e kursit dhe mbrojtja e temave të diplomave. Pas kontrollit të kryer GVJ konstatoi se kriteret ishin përcaktuar në rregulloren e FE, dhe krahas sa më sipër në rregulloren e programit të studimit përcaktohen edhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të tyre dhe parapërgatit studentët për mënyra të zhvillimit të provimit final për çdo modul (provim me shkrim).</p> <p>UNIKO aplikon disa mënyra për informimin e studentëve lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në këtë program studimi, të tilla si: ZIS dhe sekretaria mësimore; Sistemi ESSE3<sup>116</sup>; portalit të UK përmes site-ve të pedagogëve përkatës; si edhe nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë nga pedagogu i lëndë ose moduli në fillim të semestrit mësimor.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në IAL pyeti studentët nëse IAL në çdo fillim semestri për çdo vit akademik shpall në ambiente publike orarin mësimor: ditën, orën, sallën dhe personelin akademik përkatës, për çdo semestër, si edhe nëse pedagogu i lëndës bazuar në programin (syllabusi) e lëndës ku ka të</p> |

<sup>114</sup> Evidenca 3.24 Model propozimi nga njësia bazë e kriterëve specifike për transferimin, ekuivalentimin dhe vazhdimin e studimeve nga studentët

<sup>115</sup> Evidenca 5.4 Informim mbi Veprimtaritë akademike në linkun: <https://www.unkorce.edu.al/sq/node/657>; Evidenca 5.5 Databaza e Qendrës së Karrierës dhe Alumni në linkun: <https://www.unkorce.edu.al/sq/QKA>; Evidenca 5.5 Databaza e Qendrës së Karrierës dhe Alumni në linkun: <https://www.unkorce.edu.al/sq/QKA>;

<sup>116</sup> Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit

|   |  |                             |                            |                             |
|---|--|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
|   | përcaktuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve, jua prezanton ato studentëve në orën e parë të mësimit.  |                             |                            |                             |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.  | GVJ konstaton se UNIKO ka miratuar rregulloren e këtij programi studimi (Evidenca 2.5) <sup>117</sup> ku përcaktohen disa kritere që duhet të plotësojë një student lidhur me procedurat e diplomimit, procedurat për mbrojtjen e diplomes, etj. DFK në fillim të vitit të III –të akademik, duhet tu bëjë të njohur studentëve të vitit të fundit, listën e temave të propozuara për diplomë, ndarjen tyre (në grupe ose individuale) për punimin e temës, si dhe pedagogun udhëheqës përkatës të cilët miratohen gjatë semestrit të pestë. DFK për studentët e këtij programi ka miratuar një udhëzues <sup>118</sup> për përgatitjen e temës së diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen edhe kërkesat në rastin e mbrojtjes së diplomës me tezë. |                             |                            |                             |
| <b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | GVJ, në përgjigje të këtij kriteri referon konstatimet e saj të dhëna në standardin V.1. bazuar këto edhe në RVB për këtë program studimi.   |                             |                            |                             |
| <b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përbushet</b>   | <b>Përbushet pjesërisht</b> | <b>Përbushet kryesisht</b> | <b>Përbushet plotësisht</b> |
|   |  |                             |                            | <b>X</b>                    |

|  |  |
|--|--|
| <b>Standardi V.3</b>   |  |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b> |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.   | Bazuar në RVB, Kordinatori i këtij programi, Përgjegjësi i DFK dhe zyrat e tjera për mbështetjen e studentëve informojnë studentët e këtij programi në mënyrë të hollësishme në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e këtij programi studimi në plotësim dhe zbatim të neneve respektive të rregullores së FE, dhe rregullores së këtij programi studimi.   |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.   | Informacioni gjendet edhe online në arkivën e njësisë bazë në faqen elektronike të UK-së. Gjithashtu, të publikuara në formë elektronike në sitin e sekretarisë online gjenden programet e lëndëve të plota (Evidenca 2.8) <sup>119</sup> dhe të shkurtuara (Evidenca 3.19) <sup>120</sup> , si edhe udhëzuesi (Evidenca 3.21) <sup>121</sup> për praktikat mësimore. Ndërkohë planet mësimore <sup>122</sup> , lëndët dhe |

<sup>117</sup> Evidenca 2.5 Rregullore e programit të studimit

<sup>118</sup> Evidenca 3.20 Udhëzuesi për përgatitjen e diplomës

<sup>119</sup> Evidenca 2.8 Programet lëndore të programit të studimit

<sup>120</sup> Evidenca 3.19 Model program i shkurtuar

<sup>121</sup> Evidenca 3.21 Udhëzuesi i praktikës të programit Financë-Kontabilitet

<sup>122</sup> Evidenca 2.7 Plani mësimor i programit të studimit

|  |   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>  | <p>modulet<sup>123</sup> e programit të studimit si dhe kurrikulat e Stafit akademik<sup>124</sup> janë të publikuara në website të UNIKO.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Për mundësitë e punësimit dhe orientimin në tregun e punës UK informon dhe mbështet studentët përmes Qendrës së Karrierës dhe Alumnit duke krijuar lidhjen midis studentëve dhe tregut të punës dhe inkurajon studentët të planifikojnë karrierën e tyre përmes trajnimeve, forumeve, seminareve dhe takimeve individuale.</p>   |
| <p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>           | <p>E veçantë në UNIKO krahasuar me IAL të tjera publike është praktika e aplikuar "Moduli i Karrierës"<sup>125</sup>. Ky modul i përgatit studentët për tregun e punës përmes mësimit në një cikël informacionesh që përfshin: Shkrimin e Curriculum Vitae (CV); Shkrimin e letrës së interesit; Shkrimin e projekteve; Shkrimin e temës së diplomës dhe mënyrën e citimeve në punimet shkencore; Këshillim të studentëve për "Intervistën e Punës". Këto në RVB ilustrohen përmes dokumentave (Evidenca 5.8)<sup>126</sup>.</p> <p>Nga verifikimet e kryera nga GVJ, në faqen web të Universitetit gjendet gjithashtu një hapësirë e dedikuar për studentët në të cilën marrin informacion në lidhje me oraret e provimeve, kalendarin akademik, bibliotekën, etj.</p> <p>Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet nga strukturat: Sekretaria mësimore, ZIS dhe Zyra e Karrierës dhe Alumni dhe stafit akademik. Gjithashtu, sistemi ESSE3 (i mundësuar nga RASH, Evidenca 2.14)<sup>127</sup> mundëson informimin e studentëve për gjithë procesin mësimor që prej rregjistrimit deri në diplomimin e tyre. Për aksesin në ESSE3, çdo student i programit Financë-Kontabilitet, ka emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin për llogarinë e tij. Çdo student mund të ndjekë online në çdo kohë, ecurinë e veprimtarisë së tij studentore. UNIKO ju ka mundësuar studentëve një manual përdorimi të ESSE3.</p> <p>UNIKO në bashkpunim me partner të tjerë lokal organizon "Panairin e Punës". Këtu marrin pjesë institucione, ndërmarrje dhe organizata të ndryshme, të cilët prezantojnë ofertat e tyre të punës dhe njihen me kërkesat për punë të studentëve nëpërmjet komunikimit dhe intervistave me ata. Gjatë vizitës në IAL u kërkuan evidenca të punësimeve të mundshme nga këto panairë pune, por përgjigja ishte se nuk kishin ruajtur të tilla.</p> <p>Studentëve të programit Financë-Kontabilitet u jepet informacion i gjerë dhe i detajuar mbi : 1. Organizimin e procesit mësimor dhe strukturën</p> |

<sup>123</sup> Evidenca 2.20 Lëndët dhe modulet e programit të studimit

<sup>124</sup> Evidenca 2.9 Jetëshkrimet e Stafit të përfshirë në programin e studimit; Evidenca 5.7 Kurrikulat(CV) e stafit , faqja në web:<https://www.unkorce.edu.al/sq/node/717>

<sup>125</sup> Evidenca 3.26 Analiza e Veprimtarisë QKA, 2018-2019

<sup>126</sup> Evidenca 5.8 QKA- Aktivitete në kuadër të "Modulit të Karrierës" në linkun:

[https://www.unkorce.edu.al/sq/qka\\_aktivitetet](https://www.unkorce.edu.al/sq/qka_aktivitetet); Evidenca 5.9 QKA- faqja në rrjetin social Facebook në linkun:

<https://www.facebook.com/qka.unkorce/>

<sup>127</sup> Evidenca 2.14 Marëveshje institucionale



|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <p>mësimore të vitit akademik dhe sezonin e provimeve, nëpërmjet orarit mësimor<sup>128</sup> dhe grafikut të provimeve<sup>129</sup>, të cilët vendosen në standat e mjediseve të FE, si edhe në web-in e UK-së dhe FE-së.</p> <p>Aty pasqyrohen të ndara lëndët sipas viteve akademike të shoqëruara me sallën dhe lektorin ose pedagogun përkatës. 2. Infrastrukturën nëpërmjet tabelave orientuese që janë vendosur në zona të ndryshme të qytetit dhe pranë godinave të kampuseve universitare. Për orientim më të detajuar janë vendosur emërtime dhe numeracion tek godinat dhe sallat ku zhvillohet procesi mësimor dhe veprimtaritë e tjera akademike.</p> <p>Shërbimet universitare dhe fasilite të tjera si kujdestari dhe këshillim për studentët në funksion të realizimit të procesit mësimor dhe veprimtarive akademike të cilat janë përcaktuar në Rregulloren e Studimeve të UK<sup>130</sup>.</p> <p><i>Në përfundim lidhur me këtë standard, GVJ sjell në vëmendje të IAL-së se duhet gjetur mekanizmi nxitës që stafi akademik dhe zyrat përkatëse të jenë aktive dhe efçente në aplikimin dhe fitimin e projekteve të cilat kanë përfshirjen aktive të studentëve duke krijuar për ata mundësinë e marrjes së eksperiencave të para dhe angazhimin e tyre.</i></p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

|  |  |
|--|--|
| <b>Standardi V.4</b>   |  |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b> |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.  | GVJ gjatë vizitës në IAL, kërkoi të verifikojë ato çfarë evidentoheshin në RVB, se sekretaria mësimore e DFK disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.            | GVJ konstatoi se të dhëna e cituara më sipër ruhen në formë të shkruar (hard copy) sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 71 të statutit të UK-ja i cili detyrohet të mbajë në formë të shkruar në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, « Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë»:   |

<sup>128</sup> Evidenca 5.11 Orari mësimor në linkun: <https://www.unkorce.edu.al/orari-mesimor>

<sup>129</sup> Evidenca 5.12 Grafiku i provimeve në linkun: <https://www.unkorce.edu.al/article/grafiku-i-provimeve>

<sup>130</sup> Evidenca 1.2 Rregullorja e Organizimit dhe Veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>   | <p>a) Regjistrin themeltar të studentëve të UK<sup>131</sup>. Ky është i plotësuar edhe në formë elektronike (Rregullore e Sekretarisë, neni 13);</p> <p>b) Regjistrin e arritjeve akademike për çdo student të regjistruar në UK për këtë program studimi. Ky është i plotësuar edhe në formë elektronike;</p> <p>c) Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. Ky është i plotësuar edhe në formë elektronike;</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>  | <p>Sekretaria zbaton me kujdes kuadrin ligjor të sipërcituar si edhe Rregulloren e sekretarise për regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin. Kjo rregullore përcakton mbajtjen e statistikave vjetore për të diplomuarit si dhe plotësimin në kohë dhe me cilësi të të gjitha dokumentacioneve të mësipërme<sup>132</sup>.</p>   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> | <p>Pra, konkludojmë se sekretaria siguron regjistrimin e arritjeve akademike në formë të shkruar dhe elektronike të gjithë studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi e deri në diplomimin e studentëve të programit mësimor të ciklit të parë “Bachelor” në UNIKO. Gjithahstu, statistikave të sipërcituara nga UNIKO ruhen edhe në bazën e të dhënave të sistemit ESSE3<sup>133</sup> në formë elektronike. Sektori i IT, nën varësinë e Sektorit të Projekteve dhe Digjitalizimit kryen përpunimin statistikor të të dhënave, menaxhon sistemin, mjetet dhe procedurat e informacionit<sup>134</sup>. Ky sektor mirëmban platformën e sistemit dixhital të të dhënave si një mënyrë komunikimi<sup>135</sup> duke e përditësuar vazhdimisht faqen zyrtare të UNIKO<sup>136</sup>, si edhe informon mediat apo publikun e gjerë.</p> <p>Të dhënat pasqyrohen të përpunuar në mënyrë të detajuar në raportin vjetor të analizës mësimore dhe kërkimore<sup>137</sup> të njësisë kryesore si edhe në raportet analitike për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve<sup>138</sup>.</p> <p>Bazuar në RVB mund të evidentojmë si praktikë të mirë menaxheriale që Drejtorja e Kurrikulave në fillim të vitit akademik harton planin vjetor të veprimtarive të cilin e ndërton mbi bazën e gjetjeve dhe strategjive të evidentuara në raportin e vitit të mëparshëm. Ky plan veç të tjerash pasqyron edhe rekomandime në lidhje me masat që duhen marrë në vitin e ardhshëm akademik pas vlerësimit të pikave të dobta dhe të forta të UNIKO për përmirësimin e këtyre treguesve<sup>139</sup>. Për shkak të kufizimeve në vizita</p> |

<sup>131</sup> Evidenca 3.28 Udhëzuesi i MASR, modeli format i Regjistrimit bazë të studentëve të dërguar nga MASR

<sup>132</sup> Evidenca 1.10 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të UK-së, neni 7-10

<sup>133</sup> Evidenca 1.6 Manuali i sistemit elektronik ESSE3

<sup>134</sup> Evidenca 1.5 Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit shkencor

<sup>135</sup> Evidenca 5.13 Sistemi dixhital i të dhënave ESSE3 i institucionit në linkun: [www.unkorce.esse3.u-gov.rash.al](http://www.unkorce.esse3.u-gov.rash.al)

<sup>136</sup> Evidenca 5.1 Website i UK-së, [www.unkorce.edu.al](http://www.unkorce.edu.al)

<sup>137</sup> Evidenca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë

<sup>138</sup> Evidenca 4.4 Tabela e të dhënave të regjistrimit, ecurisë dhe viteve akademike (Mesatarja në hyrje dhe në dalje)

<sup>139</sup> Evidenca 5.15 Plani vjetor i DKSCSH, faqja në web:

<http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/PLANI%20VJETOR%20DREJTORIA%20E%20KURRIKULAVE%202019-2020.pdf>;

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <p>fizike në IAL gjatë vizitës nuk mund të verifikohet në vend zbatimi i këtij plani për vitin akademik 2019-2020.</p> <p>Gjithashtu UNIKO ndërton raportin vjetor me të gjithë elementët përbërës për çdo vit akademik në bazë të evidencave dhe raporteve të përcjella prej njësive kryesore dhe njësive bazë, si dhe strukturave pranë Rektoratit. Ky raport ndërtohet në zbatim të udhëzimit MASR Nr.5 datë 19. 02. 2018. Gjithashtu, informacioni i grumbulluar depozitohet në Arkivën e Rektoratit dhe është lehtësisht i aksesueshëm, i sigurt dhe i verifikueshëm nga persona të autorizuar.</p> <p>Sekretaria mësimore dhe zyrat e tjera që kanë akses në këto të dhëna kujdesen të ruajnë dhe përpunojnë të dhënat personale të studentëve bazuar në parimin e kofidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale<sup>140</sup>.</p> <p>Bazuar në RVB, rrjeti ALUMNI përditësohet mbi baza mujore nëpërmjet gjurmimit të tyre me telefon, email, ose formularë të shpërndarë në terren, me qëllim jo vetëm sigurimin e informacionit por edhe për të shkëmbyer përvojat më të mira në fushën e arsimimit dhe punësimit.</p> <p><i>GVJ konstaton se IAL duhet të bëjë më shumë për mbështetjen dhe gjurmimin e studentëve për punësimin e tyre, si dhe shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre qoftë edhe duke ofruar mundësinë e vijimit të kualifikimeve me kurse speciale që kërkon tregu i punës.</i></p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

|  |   |
|--|---|
| <b>Standardi V.5</b>   |   |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b> |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.   | UNIKO në zbatim të nenit 98 dhe 99 të Ligjit Nr. 80, 2015, dhe nenit 69 të Statutit të UNIKO <sup>141</sup> , studentët kanë të drejtë, të zgjedhin dhe të zgjidhen si përfaqësues në organet vendimmarrëse të UK-së në nivele të Senatit (10%) dhe të komisioneve <sup>142</sup> . Studentët janë pjesë aktive e vendimmarrjes në UNIKO pasi votojnë me votë të fshehtë për autoritetet drejtuese (Rektor, Dekan), përfaqësuesin e tyre në Senat <sup>143</sup> dhe në Bordin e Administrimit si |

<sup>140</sup> Evidenca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave

<sup>141</sup> Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit, neni 69

<sup>142</sup> Evidenca 5.39 Antarët e Senatit në linkun: <http://unkorce.edu.al/sq/node/647>

<sup>143</sup> Evidenca 3.30 Rregullore për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet publike të arsimit të lartë”

|  |  |
|--|--|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>   | <p>edhe bëhen pjesë e komisioneve si Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSCB)<sup>144</sup> dhe Këshillit të Etikës<sup>145</sup>.</p> <p>Sipas RVB, Rektorati i UK-së mbështet kërkesat e Këshillit studentor duke marë miratimin e Organeve Akademike dhe Administrative (në varësi të veprimatrive), në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me financimin, përfshirjen e tyre akademike ose me organizimin e veprimatrive studentore<sup>146</sup>, këto mund të verifikohen në website të UNIKO<sup>147</sup>.</p> <p><i>GVJ nuk evidentoi evidenca në RVB se UNIKO përfshin studentët në vlerësimin real dhe konkretë prej tyre të procesit akademik bazuar në rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme përmes marrjes së mendimit të studentëve të UNIKO me pyetësorët që përgatit dhe organizon NJBSC për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, dhe konkretisht edhe për programin mësimor Bachelor në "Financë-Kontabilitet". Studentët e pyetur nga GVJ nuk kishin eksperiencë apo informacion për kontributin e tyre në këtë proces.</i></p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program mësimor, u pyet nga GVJ mbi masat e marra për adresimin e gjetjeve të këtyre raporteve, dhe prej tyre u siguroa evidenc për një rast të ndodhur gjatë vitit akademik 2018-2019.</p> <p>Sipas RVB-së, para sezonit të provimeve nga studentët duhet të plotësohet pyetësori për cilësinë e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve për modulet e çdo programi studimi. Por gjithashtu thuhet se pas analizës së rezultateve të pyetësorit çdo pedagog merr në konsideratë ankesat apo edhe sugjerimet e studentëve për përmirësim të syllabusit dhe mënyrave të mësimdhënies.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> | <p>Sipas RVB-së, për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Financë-Kontabilitet" orët mësimore në auditor sipas viteve përkatësisht janë: viti i parë 645 orë, viti i dytë 735 orë dhe viti i tretë 614. <i>GVJ gjatë vizitës në IAL pyeti Njësia Bazë pse është kjo shpërndarje orësh mësimore dhe në total shkojnë 1994 orë mësimore në auditor. Zakonisht në të tilla programe studimi evidentohen nga 600 orë mësimore për çdo vit akademik dhe në total për tre vite akademike janë 1800 orë mësimore në auditor. Përgjigja ishte se kështu e kishin menduar dhe se nuk ishin në kundërshtim me VKM nr.41, datë 24.1.2018.</i></p> <p>Vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të shpërndarë gjatë semestrave në raportin ku 70% e vlerësimit përfitohet nga provimi përfundimtar dhe</p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit</p>   |  |

<sup>144</sup> Evidenca 5.42 Lista e e anëtarëve të Njësia të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC), në linkun: <http://unkorce.edu.al/sq/node/800>

<sup>145</sup> Evidenca 5.41 Lista e e anëtarëve të Këshilli i Etikës, <http://unkorce.edu.al/sq/node/648>

<sup>146</sup> Evidenca 3.31 Mbështetje financiare për veprimatritë e organizuara nga Këshilli Studentor; Evidenca 5.17 VKM nr.779, për reduktimin e tarifës për studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor,faqja ne web: [https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/perjashtim\\_nga\\_tarifa\\_2018-2019/VKM/vkm\\_nr.780\\_dt.26.12.2018\\_reduktim\\_tarifa.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/perjashtim_nga_tarifa_2018-2019/VKM/vkm_nr.780_dt.26.12.2018_reduktim_tarifa.pdf)

<sup>147</sup> Evidenca 5.18 Website i Këshillit studentor të UK-së, <https://www.unkorce.edu.al/sq/keshilli-studentor>

|  |  |
|--|--|
| <p>dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>   | <p>30% e vlerësimit përfitohet nga provimet e ndërmjetme, projektet apo detyrat e kursit.</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p> | <p>Departamenti Financë-Kontabilitet (DFK) mbështetur në pyetësorë të viteve akademike të kaluara, merr masa për të reflektuar sugjerimet e studentëve në lidhje me ngarkesat mësimore, në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Gjithashtu, bazuar në RVB evidentohet se UNIKO parashikohet përmirësimi i programeve të studimit bazuar në propozimet e studentëve: “a) Duke organizuar pyetësorin studentor<sup>148</sup> për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi në fund të çdo semestri; b) Duke marrë pjesë në prezantimin e punës mësimore dhe kërkimore ku kërkohet mendimi i tyre për përmirësime të mëtejshëm të programeve që drejton njësi bazë; c) Nëpërmjet pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programeve të studimit të organizuar nga Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, në bashkëpunim me Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, bazuar në Nenin 103, pika 3 të ligjit nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL<sup>149</sup>; d) Duke organizuar gjithashtu edhe e një pyetësor online që është pjesë e auditimit të performancës që ka ndërmarrë Kontrolli i Lartë i Shtetit për të vlerësuar në mënyrë të pavarur e objektive programet e studimit që ofrohen në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik në vendin tonë, duke kërkuar edhe mendimin e studentëve<sup>150</sup>.”</p> <p>Ndërsa RVB citon se DFK për të siguruar barazi dhe ndershmëri të kryerjes së procesit të vlerësimit të studentëve përmes ESSE3 krijon mundësinë që për çdo ndërhyrje në sistem të ngelen gjurmë për kohën dhe numrin serial të kompjuterit ku është hedhur vlerësimi dhe pas periudhës së parashikuar në rregullore të ESSE3, funksionimi i sistemit nuk lejon ndërhyrje pa një procedurë të veçantë të parashikuar në manualin dhe rregulloret e UNIKO.</p> <p>Gjithashtu, nëpërmjet sistemit ESSE3, studentët e programit “Financë-Kontabilitet” kanë mundësinë e ankimimit, rishikimit dhe deri në reflektim e ndryshimit të vlerësimit të ndërmjetëm, detyrat e kursit, por edhe për rezultatin përfundimtar të provimit. Këto kryhen bazuar në Rregulloren e UNIKO, kreu VI, nenet 100-105<sup>151</sup> dhe në rregulloren e DKSCCK-së.</p> <p><i>Gjithashtu studentët e pyetur gjatë vizitës në IAL, u shprehën se kurdo që kanë pasur ankimim të rezultetit apo nevojën për rishikim, kjo është mundësuar nga pedagogët brënda kohës prej 48 orësh.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se nuk evidentohet në RVB se ndryshimet, përmirësimet e këtij programi në vite të jenë bërë në referencë të përshtatjes së programit</i></p> |

<sup>148</sup> Evidenca 3.13 Pyetësori Studentor fundkursi për cilësinë e mësimdhënies

<sup>149</sup> Evidenca 5.34 Pyetësori studentor nga NJBSC,faqja në web: <https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSd1ix-D3v7qut05SXxsGoEIBF0EXLw0hB9liCZLXn3utoA5A/viewform>

<sup>150</sup> Link 5.19 Pyetësor për studentët në kuadër të Auditimit të performancës në IAL publike, i hartuar nga KLSH,faqja në web: <https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSe0A3Hm851N9YCRgKFÉ4QIAP08NdriV3aLn0PeXkEoKPrIFXg/viewform>

<sup>151</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO

|                                    |   |                      |                     |                      |
|------------------------------------|---|----------------------|---------------------|----------------------|
|                                    | të Studimit me propozimet e studentëve apo nga nevojat e tregut. GVJ pas vizitës në IAL ju vendos në dispozicion vetëm një rast i cili ishte në mbështetje të një propozimi nga studentët sipas analizës së pyetësorëve dhe nuk u evidentuan raste të tjera nga analiza e tregut apo alumni, etj. |                      |                     |                      |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet   | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
|                                    |   |                      | X                   |                      |

|  |   |
|--|---|
| <b>Standardi V.6</b>   |   |
| <b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>   |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.  | Në respekt të kërkesave ligjore, UNIKO ka në organigramë Drejtorinë e Kurrikulave Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor e cila ka në përbërje disa njësi <sup>152</sup> . Këto njësi kanë për qëllim për të mbajtur të informuar, këshilluar dhe ndjekur përparimin e studentëve. Gjithashtu, pranë FE, ndodhet Sekretaria mësimore dhe Sekretaria e departamentit të cilat luajnë një roj aktiv në plotësimin e kërkesave të studentëve në kohën e duhur <sup>153</sup> .  |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.   | Për zhvillimin e mësimin online, stafi IT i UNIKO së bashku me RASH ka përgatitur dhe personalizuar dy aplikacione: Edumeet dhe Moodle për të gjithë përdoruesit (stafin akademik dhe studentët e UNIKO). Por, ende UNIKO nuk ka përcaktuar një platformë të vetme dhe unike për tu përdorë në gjithë Universitetin si p.sh. Teams, Zoom apo Meet. Çdo pedagog është i lirë të zgjedhi për të punuar në platformën e komunikimit që dëshiron duke përfshirë platforma të ndryshme, udhëzuesit e të cilave gjenden të pasqyruara në website-in e UNIKO <sup>154155156157</sup> .                   |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të | UNIKO kujdeset t'ju ofroj studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës dhe orientimin në tregun e punës nisur që prej zgjedhjes dhe orientimit për praktikën profesionale <sup>158</sup> në bizneset apo institucionet duhura. Këto asistohen përmes Qendrës së Karrierës dhe Alumnit (QKA) e cila shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe punëdhënësve. QKA bazuar në rregulloren e saj dhe në bashkëpunim me DFK nxit kërkimin shkencor dhe planifikimin e karrierës së studentëve të këtij programi studimi, përmes trajnimeve, leksioneve të hapura, forumeve, projekteve, seminareve, |

<sup>152</sup> Të tilla si: Sektorin e Kurrikulave dhe sigurimit të Cilësisë, Sektori i Projekteve Kërkimit Shkencor dhe Dixhitalizimit, Qendrën e Karrierës dhe Alumni dhe Sektori i Bibliotekës Universitare

<sup>153</sup> Evidenca 5.21 Organograma e FE,faqja në web: <https://www.unkorce.edu.al/sq/node/713>

<sup>154</sup> Evidenca 5.1 Website i UK, <http://www.unkorce.edu.al/sq>

<sup>155</sup> Evidenca 5.22 Akses për aplikacionin online Edumeet , <https://edumeet.unkorce.rash.al/>

<sup>156</sup> Evidenca 3.4 Manuali i përdorimit të aplikacionit Edumeet

<sup>157</sup> Evidenca 5.23 Akses për aplikacionin online Moodle, <https://moodle.unkorce.rash.al/>

<sup>158</sup> Evidenca 3.21 Udhëzuesi për praktikën

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| tjera dhe orientimin në tregun e punës.  | takimeve informuese, tryezave të rumbullakëta, takimeve të studenteve <sup>159</sup> , etj.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Gjithashtu, QKA kujdeset për përgatitjen e Panairit të Karrierës, pjesëmarrjen në panairin e punës <sup>160</sup> , si edhe përmes një platformë online <sup>161</sup> sigurohet një databazë e detajuar e plotësuar me informacion periodik për tregun e punës, por edhe ka ndërtuar një sistem database (kërkesa ose oferta pune, vende të lira pune) <sup>162</sup> . QKA bashkëpunon me FE dhe ka krijuar një bazë të dhënash <sup>163</sup> krahas atyre të tjerë të diplomuar në UNIKO <sup>164</sup> në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar në këtë program studimi. Sipas RVB-së, të gjitha këto të dhëna DFK i përmbledh në një studim periodik të tregut të punës të cilin e merr parasysh për miratimin e kuotave të pranimit. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              |                             | X                            |

<sup>159</sup> Evidenca 5.4 Informim mbi Veprimtarite akademike në linkun: <https://www.unkorce.edu.al/sq/node/657>

<sup>160</sup> Evidenca 5.10 Panairi i punës 2019 në linkun: <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/uniko-prezantoin%C3%AB-%E2%80%9Cpanairin-e-pun%C3%ABs-2019%E2%80%9D-ofert%C3%ABn-e-tij-akademike2019-2020>

<sup>161</sup> Evidenca 5.24 Platfoma online e informimit të studentëve mbi kërkesën dhe ofertën e tregut të punës, faqja në web: <https://www.unkorce.edu.al/sq/punësime>

<sup>162</sup> Evidenca 5.35 Njoftime për vende të lira pune, faqja në web: <https://www.unkorce.edu.al/njoftime-p%C3%ABr-vende-t%C3%AB-lira-pune>; Evidenca 4.13 Databaza e punëdhënësve aktive

<sup>163</sup> Evidenca 4.6 Tabela e punësimit të studenteve, Financë-Kontabilitet: 2016-2019

<sup>164</sup> Evidenca 5.25 Baza e të dhënave për gjurmimin e studentëve të diplomuar 2016-2019 <https://www.unkorce.edu.al/sq/qka-statistika>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

| <b>Standardi VI.1</b>   |  |
|---|--|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>  |  |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>   | <p>Bazuar ne RVB dhe viziten ne institucion, GVJ vlereson se, UNIKO në zbatim të detyrimit të Ligjit të Arsimit të Lartë<sup>165</sup> Nr. 80/2015, pika 1, Statutin<sup>166</sup> dhe Rregulloren e Institucionit<sup>167</sup>, ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë duke përfshire edhe programin Bachelor ne "Financë-Kontabilitet".</p> <p>Parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë UNIKO i ka specifikuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë (Aneksi 1.1 6), miratuar me Vendimin nr.300, datë 10.07.2020 të Senatit Akademik<sup>168</sup> si edhe në</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>   | <p>Njesia pergjegjese per sigurimin e brendshem te cilesise eshte NJSBC e cila si strukture eshte e parapare ne Statutin e UK-se (Aneksi 1.01). Gjithashtu, politika per sigurimin e cilesise ne UK ishte publike dhe ishte Planin Strategjik 2016-2020<sup>169</sup> (Aneksi 1.03) ishin të parashtruara politikat dhe procedurat që do të ndjekë institucioni në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC perbehet nga perfaqesues nga çdo njësi kryesore, studentë dhe ekspert i jashtëm.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p> | <p>Sipas RVB, evidentojmë se ka nje konfuzitet në ngritjen e NJSBC-ve pranë çdo njësie kryesore me propozim te Dekanit, sipas rregullores së FE (Aneksi 1.27), pasi diku tjetër shkruhet se brenda Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me përfaqësues një koordinator nga çdo njësi kryesore. Ndërsa, pranë çdo njësie kryesore ngrihet GVB, e cila për Fakultetin e Ekonomisë (FE) ka përfaqësim nga 3 njësitë bazë dhe 1 përfaqësues i studentëve<sup>170</sup>.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të</p>  | <p>Sipas RVB-së, “GVB monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht<sup>171</sup>, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Njësia funksionon në bazë të Rregullores së brendshme të Fakultetit të Ekonomisë miratuar në mbledhje Senati me Vendim Nr. 511, datë 30/ 09/2019<sup>172</sup>. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve,</p>  |

<sup>165</sup> Evidenca 2.16 Ligji 80/2015, nenet 6, 33, 38, 46, 87, 98, 99, 103, 104

<sup>166</sup> Evidenca 1.1 Statuti I UniKO, Kreu IX, Neni 73, 74

<sup>167</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore e UNIKO

<sup>168</sup> Evidenca 1.16 Manuali i Cilësisë UNIKO

<sup>169</sup> Shtrojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO 2016-2020

<sup>170</sup> Evidenca 3.4 Lista e anëtarëve të NJSBC

<sup>171</sup> Evidenca 3.7 Raportet vjetore të NJSBC

<sup>172</sup> Evidenca 2.12 Rregullorja e njësisë bazë Kreu XIII, neni 101



|  |   |                                     |                                    |                                     |
|--|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p> | <p>organizohet pyetsor i studentëve për cilësinë<sup>173</sup> e mësimdhënies për modulet e çdo program studimi në semestrin përkatës”.</p> <p>Sipas RVB, nga GVB bëhet vlerësim i brendshëm i programit të studimit si rregull një herë në vit të cilat përdoren si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe për vlerësimin e jashtëm<sup>174</sup>. Gjatë vizitës në IAL, ekspertët pyetën përfaqësuesit e NJSBC për:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. shpeshhtësinë e raportimit në informimin e drejtuesve të njësive bazë dhe përmes tyre të gjithë stafin e DFK-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit<sup>175</sup>, njësive të tij baze dhe individëve në të ardhmen. Përgjigja e tyre ishte se përpilohej një raport vjetor, ndërkohë që studentët anketoheshin në përfundim të semestrit. Duke qenë se nga IAL na u ekspozua se ku mund të gjendeshin raportet vjetore të GVB për 3 vitet e fundit, nuk u kërkua depozitimi i tyre edhe përmes sistemit AMS.</li> <li>2. Çfarë masash janë marrë në rast të gjetjes së mospërputhjeve në plotësimin e standardeve të cilësisë sipas manualit? Për këtë nuk u depozituan evidenca.</li> </ol> <p><i>Në përfundim, GVJ rekomandon që NJSBC të organizoj marrjen e opinionëve të studentëve për çdo semestër përmes pyetësorëve për cilësinë<sup>176</sup> vetëm para se të filloj sezoni provimeve., si edhe të mbaj evidencat për të reflektuar ndjekjen e plotësimit të rekomandimeve të dhëna nga raportet e posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i></p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>  | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|  |   |                                     | <p><b>X</b></p>                    |                                     |

|   |   |
|---|---|
| <p><b>Standardi VI.2</b><br/> <b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p> |   |
| <p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>   | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>GVJ evidenton se DFK është njësi kryesore që duhet të marrë përsipër të drejtën dhe detyrimin për përmirësimin dhe rishikimin e programit mësimor. Ndërsa, NJSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit.</p> |

<sup>173</sup> Evidenca 3.13 Pyetsori studentor

<sup>174</sup> Evidenca 3.7 Raportet vjetore të NJSBC

<sup>175</sup> Nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kerkimore, menaxhuese, infrastrukurore, ...me qellim që të arrihen nivele maksimale në procesin mësimor dhe kerkimor.

<sup>176</sup> Evidenca 3.13 Pyetsori studentor

|   |   |  |  |          |
|---|---|--|--|----------|
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë. | <p>Sipas RVB: “Pranë çdo Departamenti organizohet dhe funksionon Komisioni për Sigurinë e Cilësisë së Programeve të studimit<sup>177</sup>. Ky komision ka në përbërje 3 anëtarë (2 personel akademik dhe 1 student). Në fund të çdo viti akademik Komisioni për çdo program studimi harton një raport lidhur me elementët e cilësisë dhe kërkimit shkencor. Raporti diskutohet dhe miratohet nga Departamenti përkatës. NJSBC realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga FE. Analiza e sigurimit të brendshëm të cilësisë në lidhje me aktorët e përfshirë në programet e studimit hedh idenë e rishikimit të kurrikulave, në bazë të të dhënave të vjela nga pyetësorët dhe sondazhet me studentët. Bazuar mbi këto, realizohet Analiza SWOT, e cila shërben si një plan veprimi për përmirësim të mëtejshëm. Asambleja e fakultetit dhe personeli administrativ diskutojnë mbi raportin në një takim të hapur dhe pasi miratohet, ai i dërgohet Rektoratit”.</p> <p><i>Në RVB mungojnë evidenca dhe link për publikimin online të raporteve të vlerësimit të cilësisë. Ekspertët gjatë vizitës kërkuan t’ju prezantohen disa prej këtyre raporteve, analizave dhe evidentimin e adresimit të tyre. GVJ i rekomandon Senatit Akademik, dhe Bordit të Administrimit të UNIKO të kërkojnë një analizë (follow up) të zbatimit të detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga këto raporte për përmirësimin në vijim të cilësisë.</i></p> |  |  |          |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.  |   |  |  |          |
| <b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.                                    |   |  |  |          |
| <b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. |   |  |  |          |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  |   |  |  |          |
|   |   |  |  | <b>X</b> |

| <b>Standardi VI.3</b>  |   |
|--|---|
| <b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>  |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | <p>UNIKO ka përgjegjësinë t’i ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve mësimore, të tregojë se po bën përpjekjet e mundshme për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase burimet e siguruar nga buxheti i shtetit, studentët e saj, etj., dhe të sigurojë që janë plotësuar standardet e cilësisë.</p> <p>GVJ konkludon se raportet dhe vlerësimet e NJSBC bëhen në nivel institucional dhe nuk konstatohet të ketë vlerësim nga NJSBC për këtë program specifikisht, por nga analiza e përgjithshme institucionale, DFK evidenton elementet që lidhen me programin “Financë Kontabilitet”.</p> |
| <b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor   |   |

<sup>177</sup> Evidenca 2.2 Rregullorja e njësisë kryesore FE 19-20 Kreu II, neni 11

|  |   |                                     |                                    |                                     |
|--|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>  | <p>Me qëllim rritjen e cilësisë për këtë program studimi, UNIKO ka përdorë disa metoda dhe instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të këtij programi studimi. Të tilla janë: sondazhe dhe intervista me studentët aktuale, me ato të diplomuar (alumni), me personelin akademik, ndihmes akademik e administrativ.</p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p> | <p>Referuar RVB-së, në nivel fakulteti ka pasur vetëvlerësim po nuk ka pasur vlerësime të jashtme dhe auditime. Njësia bazë në mënyrë të përvitshme harton raportet e veprimtarisë institucionale të cilat përfshijnë analizën e procesit mësimor dhe atë të kërkimit shkencor me të gjithë komponentët e vlerësimit të tyre<sup>178</sup>...Nga analiza e vlerësimeve janë nxjerrë rekomandime dhe janë lënë detyra në lidhje me rregullsinë e procesit mësimor dhe cilësinë e mësimdhënies.”</p> <p><i>GVJ i sugjeron IAL-së që përveç metodave që ai aplikon dhe atyre të cituara më herët nga GVJ duhet të përdorë edhe metoda dhe instrumenta të tjera të standardizuara të cilat ndihmojnë vlerësimin dhe ndërtimin e qëndrueshëm të cilësisë së programit të studimit, disa të tilla mund të jetë vlerësimi 360 gradë si një teknikë koherente perëndimore e aplikueshme për vlerësimin e eprorëve, kolegëve dhe vartësve në universitete.</i></p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>                |   |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>  | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|  |   |                                     |                                    | X                                   |

<sup>178</sup> Evidenca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë

| <b>Standardi VI.4</b><br><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b>                               |  |
|---|--|
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.                      | Nga dokumentacioni i depozituar evidentohet se në Statutin e UNIKO, Manualin e Cilësisë (Aneksi 1.16), Rregulloren e FE (Aneksi 1.27) dhe Rregulloren e DKSKC (Aneksi 1.05), përcaktohen njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.<br><br><i>GVJ nga përgjigjet e marra gjatë vizitës në IAL konstaton se ende nuk ka të ngritur Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Fakulteti, ku pjesë e tij do të ishte edhe stafi i njësisë bazë dhe studentët e këtij programi mësimor.</i>   |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.                          | <i>Gjithashtu, GVJ konstaton se nuk ka evidenca (dokumenta) që tregojnë se është bërë aq sa duhet lidhur me përfshirjen më të gjerë të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm të cilët mund të japin ekspertizë të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</i><br><br><i>GVJ i sugjeron IAL-së:</i><br><ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <i>Organizimi i takimeve të herë pas herëshme me ekspertë, dashamirës dhe bashkëpunëtor të UNIKO për të diskutuar standardet, sigurimin e cilësisë, procedurat e vlerësimit dhe interpretimin e rezultateve të vlerësimit.</i></li> <li>➤ <i>Pas çdo lloj vlerësimi dhe analize duhet të merren masat e nevojshme konkrete të përcaktuara në kohë për tu zbatuar dhe pas çdo semestri të vlerësohet progresi apo regresi dhe axhustimet e nevojshme që duhen bërë.</i></li> <li>➤ <i>Strategjitë për rritjen e UNIKO dhe ruajtjen e cilësisë në të njëjtën kohë të analizohen në lidhje me zhvillimet dhe nevojat e ekonomisë dhe shoqërisë në rrafshin lokal, rajonal, dhe kombëtar brënda kapaciteteve të UNIKO, mundësisë për mbështetje me fonde dhe tarifa, si edhe marrjes në konsideratë të orientimit strategjik të përgjithshëm kombëtar.</i></li> </ul> |
| <b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademiq e administrative dhe studentët e programit të studimit. |  |
| <b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.  |  |
| <b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyer                             |  |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. |                       |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>                | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              | X                           |                              |

| <b>Standardi VI.5</b>   |   |
|---|---|
| <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>                 |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Bazuar në RVB: “informacioni në lidhje me politikat dhe praktikën që lidhen me sigurimin e cilësisë në UK janë të aksesueshme nga i gjithë komuniteti brenda universitetit përfshi edhe studentët duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.”<br><br>GVJ nuk konstaton në RVB për këtë IAL se ka respektuar kërkesat e standardeve duke siguruar transparencë për publikimin edhe në faqen web të UNIKO të Raporteve për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve. Në këtë mënyrë nuk sigurohet transparenca për studentët dhe të gjithë palët e interesuara. |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.  | Sipas statutit të UNIKO, nuk ishte i qartë nëse ishte detyrim ekzistenca e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë së Institucionit, si organ përgjegjës para Senatit për sigurimin e cilësisë në këtë IAL. Nga GVJ sipas përgjigjeve të dhëna nga të intervistuarit u konstatua se nuk ekziston ky komision në nivel institucional.  |
| <b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.  | <i>GVJ i rekomandon UNIKO të vlerësoj mundësinë e krijimit të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë në nivel Institucioni me anëtar me mandat dhe raportim në Senatin Akademik të UNIKO. Ngritja e këtij komisioni do të shërbejë për nxitjen, promovimin dhe monitorimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë në UNIKO si edhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë për këtë program studimi.</i>  |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.                           |   |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.                        |   |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|                                     |                |                       |                      | X                     |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|   |                |                       |                      | X                     |

## SWOT

### Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni ka hapësira të bollshme dhe në nivel të një kampusi të mirëorganizuar dhe për më tepër duke rikonstrutuar edhe facilitetet e nevojshme për zhvillimin e mësimin për studentët e këtij programi studimi.
2. Syllabuset e lëndëve të programit të studimit janë të organizuara qartë dhe i ndihmojnë studentët të njohin paraprakisht rezultatet e të nxëniet në cdo disiplinë mësimore.
3. Shumë aktiv në lidhjen e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve konkrete të Fakultetit të Ekonomisë me fakultete të tjera homologe brenda dhe jashtë vendit.
4. Marrëdhënie të mira me studentët.
5. Pavarësisht prirjes në rënie të numrit të studentëve në këtë program studimi, stafi akademik dhe drejtuesit e njësive zotërojnë emër të mirë mes studentëve dhe palëve të tjera të interesit përfitues të këtij programi studimi.

### Pika të dobta:

1. Mungesë e veprimeve konkrete apo planeve të miratuara për digjitalizimin e Bibliotekës.
2. Mungesë të përfshirjes në projekte ndërkombëtare për kërkim - zhvillim dhe bashkëpunim me universitete dhe partnerë të tjerë perëndimorë.
3. Kapacitete të pamjaftueshme laboratorike dhe mungesë të programeve profesionale të teknologjisë së informacionit me karakter aplikativ.
4. Mungesë të hartimit dhe miratimit të buxhetit të Universitetit bazuar në analizën e kostos për student për çdo program studimi, ndërkohë që evidentohet se për vitin akademik 2018-2019 ka një rritje të kostos mesatare për student "Grant i Buxhetit të Shtetit" me rreth 50% krahasuar me vitin akademik 2015-2016.
5. Mungesa e stafit në Njësinë e Auditimit të Brendshëm të UNIKO dëmton veprimtarinë dhe performancën e kësaj IAL-je.
6. Mungesa e përfshirjes së studentëve për marrjen e mendimit të tyre për pyetësorët që përgatit dhe organizon NJBSC për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit mësimor Bachelor në "Financë-Kontabilitet".
7. Mungesa e përfshirjes së studentëve, alumni dhe studimeve të tregut në vlerësimin dhe përmirësimin e këtij programi mësimor ndër vite.

8. Mungesë e evidencave për të vërtetuar nëse janë ndjekur plotësimet e rekomandimeve të dhëna nga raportet e posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

#### **Rekomandime:**

1. Organet drejtuese të UNIKO të mundësojnë digjitalizimin e Bibliotekës, e cila do të mundësojë një përjasje moderne dhe akses online të studentëve dhe pedagogëve në literaturën bashkëkohore.
2. IAL duhet të gjejë strategjitë e duhura për nxitjen e pedagogëve për përfshirjen e tyre në projekte ndërkombëtare për të siguruar mbështetjen e tyre në kërkim- zhvillim, në mënyrë që arritjet e tyre të kthehen në një qasje të natyrshme të rritjes së performancës aplikative me përfitim për studentët e këtij programi dhe gjithë komunitetin që mbulon Qarku i Korçës.
3. Të plotësohen kushtet e nevojshme për mundësimin e trajtimit të njohurive aplikative për lëndët e këtij programi mësimor në laboratore të pajisur me programe profesionale sipas natyrës specifike të disa prej lëndëve të planit mësimor të këtij programi si për shembull, Alpha, Alpha Business, Financa 5, SPSS, etj.
4. IAL duhet të hartojë një plan pune me masa konkrete lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit të UNIKO për vitin e ardhshëm akademik, bazuar në analizën e kostos për student për çdo program studimi.
5. UNIKO duhet menjëherë të plotësojë me staf Njësinë e Auditimit të Brendshëm në zbatim të nenit 116 të Ligjit Nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” me qëllim që kjo njësi të jetë funksionale dhe kryejë detyrat e saj.
6. NJSBC të marrë masat të përfshijë studentët e programit mësimor Bachelor në “Financë-Kontabilitet” e të marrë mendimin e tyre për ndërtimin e pyetësorëve lidhur me cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit mësimor të tyre.
7. Njësia bazë të marrë menjëherë masat të përfshijë studentët, alumni dhe studimet e tregut në vlerësimin dhe përmirësimin e programit mësimor Bachelor në “Financë-Kontabilitet”.
8. NJSBC të organizojë marrjen e opinionëve të studentëve për çdo semestër përmes pyetësorëve për cilësinë para se të fillojë sezoni i provimeve dhe jo në përfundim të tij. Gjithashtu, të kërkojë nga njësia bazë evidenca që reflektojnë ndjekjen e plotësimin të rekomandimeve të dhëna nga raportet e posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.
9. Senati Akademik dhe Bordi Administrimit të UNIKO të kërkojnë një analizë (follow up) të zbatimit të detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga raportet e vlerësimit të cilësisë (të brendshëm apo të jashtëm si ASCAL, etj).



10. UNIKO të vlerësojë mundësinë e qartësimit të statutit për krijimin e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë në nivel Institucioni me anëtarë me mandat dhe raportim në Senatin Akademik të UNIKO. Ngritja e këtij komisioni do të shërbejë për nxitjen, promovimin dhe monitorimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë në UNIKO si edhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë për këtë program studimi.

#### **Strengths:**

1. The institution has plenty space and at the level of a well-organized campus and it will be more after reconstructing the necessary facilities spaces for students of this study program.
3. The syllabus of this study program are clearly organized and help students to know in advance the learning outcomes in each teaching discipline.
4. Very active in concluding concrete agreements and collaborations of the Faculty of Economics with other counterpart faculties inside and outside the country.
5. Good relationships with students.
6. Despite the decreasing trend of the number of students in this study program, the academic staff and the heads of the units have a good name among the students and other stakeholders of this study program.

#### **Weaknesses:**

1. Lack of actual actions or approved plans for the digitization of the Library.
2. Lack of involvement in international projects for research, development and cooperation with universities and other western partners.
3. Insufficient laboratory capacities and lack of some applicative professional software.
4. Lack of drafting and approval of the University budget based on the cost analysis for students for each study program while it is evident that for the academic year 2018-2019 there is an increase in the average cost per student "State Budget Grant" by about 50 % compared to the academic year 2015-2016.
5. Lack of staff in the Internal Audit Unit of UNIKO impairs the activity and performance of this HEI.
6. Lack of involvement of students to get their opinion on the questionnaires prepared and organized by the Internal Quality Assurance Unit for the quality of teaching for the subjects of the Bachelor curriculum in "Finance-Accounting".
7. Lack of involvement of students, alumni and market studies in the evaluation and improvement of the program curriculum over the years.
8. Lack of evidence to verify whether the fulfillment of the recommendations given by the special reports for quality assurance of the study programs within the structures of the internal quality assurance system have been followed.

### **Recommendations:**

1. The governing bodies of UNIKO to enable the digitalization of the library which will enable a modern approach and online access of students and professors to contemporary literature.
2. HEIs should find appropriate strategies to encourage academic staff to be involved in international projects to ensure their support in research and development, in this way their achievements will turn into an applicative performance with benefit to the students of this program and the whole community covered by the Korça Region.
3. To meet the necessary conditions to enable the treatment of applied knowledge for the subjects of this curriculum in laboratories equipped with professional programs according to the specific nature of some of the subjects of the curriculum of this program such as Alpha, Alpha Business, Finance 5, SPSS, etc.
4. HEIs should draft a work plan with concrete measures related to the drafting and approval of the UNIKO budget for the next academic year based on the cost analysis for students for each study program.
5. UNIKO must immediately recruit staff for the Internal Audit Unit pursuant to Article 116 of Law no. 80/2015 on "Higher Education and Scientific Research in Higher Education Institutions in the Republic of Albania" in order for this unit to be functional and perform its duties.
6. Internal Quality Assurance Unit should take measures to include students of this study program "Finance-Accounting" in obtaining their opinion on the construction of questionnaires on the quality of teaching for the subjects of their curriculum.
7. The basic unit (Finance-Accounting Department) should immediately take measures to include students, alumni and market studies in the evaluation and improvement of the Bachelor curriculum in "Finance-Accounting".
8. Internal Quality Assurance Unit to organize the receiving of students' opinions for each semester through quality questionnaires before the start of the exam season and not at the end of it. Also, to request from the basic unit (Finance-Accounting Department) evidence that reflects the follow-up of the fulfillment of the recommendations given by the special reports for the quality assurance of the study programs within the structures of the internal quality assurance system.
9. The Academic Senate and the Board of Directors of UNIKO to request a follow-up analysis of the implementation of tasks or measures for addressing the findings, shortcomings and recommendations identified by quality assessment reports (internal or external as ASCAL, etc.).
10. UNIKO to evaluate the possibility of clarifying the statute for the establishment of the Standing Committee for Quality Assurance at the Institution level with mandate and reporting to the Academic Senate of UNIKO. The establishment of this commission will serve to promote and monitor quality assurance activities in UNIKO as well as the structures responsible for quality assurance for this study program.

## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT   | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS |                       |                      |                       |
|---|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|   | Nuk përmbushen                                 | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT  |  |                       |                      | X                     |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR |  |                       |                      | X                     |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT                                      |  |                       |                      | X                     |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT  |  |                       | X                    |                       |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE  |  |                       |                      | X                     |
| VI. SIGURIMI i CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE  |  |                       |                      | X                     |
| VLERËSIMI TËRËSOR   |  |                       |                      | X                     |

